

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: LETËRSI SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Vendi i Andon Zako Çajupit në letërsinë dhe dramaturgjinë shqiptare

MENTORJA:

Dr.Rovena Vata

KANDIDATI:

Bernard Zeka

Gjakovë, 2018

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: LETËRSI SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Vendi i Andon Zako Çajupit në letërsinë dhe dramaturgjinë shqiptare

Komisioni:

Kryetar _____

Anëtar _____

Anëtar _____

MENTORJA:

Dr. Rovena Vata

KANDIDATI:

BERNARD ZEKA

Gjakovë, 2018

PASQYRA E LËNDËS

HYRJE	5
1. Objekti dhe motivimi i temës	5
2. Metodologjia dhe metodat e punës	6
3. Baza teorike e punimit	6
4. Synimi i temës	6
KREU I: Jetëshkrimi dhe vendi i tij në letërsinë e Rilindjes Kombëtare	12
1.1 Vendi i Çajupit në letërsinë shqipe	12
1.2 Vendi i Çajupit në historinë e kulturës shqiptare	19
1.3 Vendi i Çajupit në koloninë shqiptare të Egjiptit	26
Kreu II: Leximi kritik i veprës së Çajupit	31
2.1 Tradita folklorike në veprën e Çajupit	31
2.2 Veçori të ligjërimit poetik në veprën e Çajupit	34
2.3 Tradita dhe modernja në veprën e Çajupit	38
KREU III: Vendi i Çajupit në komediografinë shqiptare	41
3.1 Elementet e dramave të Çajupit	41
3.2 Komedia 14 vjeç dhëndër	47
3.3 Baba Musa Lakuriq	48
PËRFUNDIME	53
BIBLIOGRAFIA	55

Falënderimet

Falënderim te posaçëm i shpreh udhëheqësit të këtij punimi:

Dr. Rovena Vata, profesoreshë e Fakultetit Filologjik të Universitet “Fehmi Agani” Gjakovë, e cila me korrektësinë maksimale më ka ndihmuar, në çdo kohë dhe ka qenë e gatshme për të më dhënë këshilla, sugjerime e mendime për realizimin dhe përfundimin e këtij punimi.

Jam mirënjohës i të gjithëve, që në çfarë do mënyre kontribuan në kryerjen dhe përfundimin e këtij punimi e sidomos:

Profesorëve, Asistentëve, stafit udhëheqës dhe gjithë personelit të Universitetit “Fehmi Agani”, të cilët në mënyrën më të mirë të mundëshme u munduan që dijen e tyre ta transmetojnë edhe tek ne studentët.

Në veçanti falënderoj dekanin Prof. Kamber Kamberi dhe shefin e degës Prof. Besim Muhadri për dijen që na kanë dhënë për vite me radhë.

Gjithashtu e falënderoj familjen time, të cilët më mbështeten drejt rrugëtimit tim në përfundimin e këtij synimi.

Dhe mbi të gjitha falënderoj të madhin Zot.

HYRJE

1. Objekti dhe motivimi i temës

Letërsia e Rilindjes Kombëtare është periudha historike-letrare më e rëndësishme e zhvillimit kombëtar, pasi vetëm në këtë kohë arti letrar arriti të vendoset në baza të shëndosha shoqërore kombëtare, të ushqehet me problemet e saj dhe t'u shërbejë qëllimeve të saj.

Kjo periudhë e letërsisë sintetizon idetë romantike-iluministe, realiste si dhe realiste-kritike, prandaj meriton studime historike letrare nga të gjitha aspektet, si në rrafshin përmbajtësor e formal, edhe në rrafshin estetik, etik, sociologjik, filozofik, horizontal e vertikal, pasi vetëm në këtë mënyrë do ta njohim veten më mirë, do të njohim përpjekjet individuale dhe kolektive, vetëmohimin dhe sakrificimin e një plejade të tërë me idealet më të larta kombëtare, për të ngritur historinë e letërsisë shqipe në nivelin që ajo prezantohet sot e gjithë ditën.

Objekti i shkencës sonë letrare është studimi monografik e historik letrar i çdo studiuesi të kësaj periudhe, aq më tepër i atyre që kanë qëndruar në frontin e parë të lëvizjes kombëtare, i atyre që kanë ndjekur më besnikërisht traditën krijuese, por edhe që kanë dhënë diçka të re e progresive për kohën e për më vonë, pra i atyre që kanë qëndruar në udhëkryqet letrare, që në një moment kanë mbyllur dhe po në atë moment kanë shpaluar një faqe të re të procedimit letrar.

Kjo aq më tepër pse historia nuk ka qenë njëlloj e drejtë dhe objektive me të gjithë rilindësit, veçmas me ata që patën fatin e mirë po edhe të keq të përjetojnë ditët e lirisë e të pavarësisë kombëtare. Ata si elementi kombëtar më i vetëdijësuar ndryshe e kishin menduar Shqipërinë e lirë e të pavarur e ajo u doli krejtësisht ndryshe.

Andon Zako Çajupi është nga ata shkrimtarë të Rilindjes Kombëtare të fillimit të shek. XX, që ka trashëguar nga e kaluara letrare, por që njëkohësisht i ka dhënë kësaj letërsie më tepër se i ka marrë, ka qëndruar me plot kuptimin e fjalës në udhëkryqin letrar, shkrimtari që përjetoj ditën e lirisë e të pavarësisë kombëtare, por që kjo ditë nuk e solli atë Ditën e Bardhë, që e kishte ëndërruar ai dhe bashkëveprimtarët e tij. Këtyre pikëpamjeve u qëndroi parimor gjatë tërë jetës së tij, pa pasur asnjë moment dileme apo pa bërë kompromis, prandaj dyert e atdheut të tij për njeriun aq të dëshiruar, aq luftëtar idealist, u mbyllën një herë e përgjithmonë. Natyrisht kjo jo vetëm për ekzistencën e tij fizike, por jo edhe shpirtërore.

Andon Zako Çajupi ashtu si shumë rilindës të tjerë nuk është vetëm letrar që qëndron në udhëkryqet e saj, por edhe ideolog i saj, një projektues dhe luftëtar i zjarrtë që mori pjesë në vlimet politike të kohës për fatin e pavarësisë dhe të ruajtjes së integritetit të atdheut, që luftoi si askush tjetër kundër elementëve antipatriotikë, antidemokratikë dhe antipopullorë.

2. Metodologjia dhe metodat e punës

Për të bërë të mundur realizimin e kësaj pune ne do të përdorim disa metoda, siç është metoda biografike, e cila përmes fakteve të vërteta që ndikuan në jetën e autorit, në mënyrën që u rrit, mënyrën sesi u shkollua dhe në mënyrën sesi emigroi jashtë atdheut ndikuan në botëkuptimin e tij letrar dhe jetësor, metoda sociologjike dhe psikologjike, të cilat u bënë shkas për të nxjerrë në dritë të dhënat nga rrethanat e jetës dhe mjedisit si dhe shpesh herë këta faktorë të mjedisit ku ai jetoi, ndikuan edhe në gjendjen e tij shpirtërore. Gërshetimi i këtyre tre metodave në gjuhën akademike, përbëjnë atë që e quajmë metodologji e kërkimit të punës shkencore.

3. Baza teorike e punimit

Për të realizuar këtë temë diplome si fillim jemi mbështetur në veprën e vetë autorit, si në kontributin që ai ka dhënë në letërsinë dhe dramaturgjinë shqiptare, por mbi të gjitha në studime, monografite dhe në artikujt që e kanë studiuar Andon Zako Çajupin. Përmendim këtu studimin e akademikes Floresha Dado, studimet që ka bërë studiuesi dhe akademiku Shaban Sinani dhe studimet që ka bërë Robert Elsie në historinë e letërsisë shqiptare.

4. Synimi i temës

Vendi i Çajupit në letërsinë shqipe është i njohur, por më vend është të përmendim vendin e tij që luajti në zhvillimin e dramaturgjisë shqipe. Synimi ynë në këtë punim është nxjerrja në pah e sa më shumë fakteve që Çajupi ndikoi në zhvillimin e letërsisë, por në veçanti të dramaturgjisë shqiptare.

Veprat dramatike të Çajupit janë të pakta, po ato, bashkë me "Ermirën" e Santorit, pjesët e Babit, De Martinos, Gramenos, Nolit, Kr. Floqit etj, janë përpjekjet e para për një dramaturgji shqipe. Ato janë nga veprat e para më të mira të kësaj gjinie në gjuhën tonë. Çajupi shkroi dy komedi me një akt dhe dy drama të gjata në vjersha; prej këtyre të fundit, njëra nuk njihet, drama "Detyra".

Komedia e tij e parë, "Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr" (1902) – në katër pamje, tablo apo skena, e merr temën nga jeta e fshatit: Çajupi godet me një art të sigurtë e me shumë lezet zakonin prapanik të martesave të papërshtatshme në moshë: një djalë i vogël me një vajzë të madhe. Tema është e njohur në poezinë popullore. Meritë e posaçme e poetit në këtë komedi, është krijimi i personazhit të Tanës.

Tipi i gruas prapanike fshatare, që ndonëse e shtypur dhe e shfrytëzuar prej burrit, nuk kërkon ndryshimin e zakoneve që po e sfillitin, po përkundrazi, përjetësimin e tyre. Tana do ta martojë djalin

e saj të vogël, jo për lumturinë e tij, por se ka nevojë për ndihmë, këtë ndihmë mund ta gjejë vetëm te një nuse e shëndoshë:

*Nuk dua nuse për sisë,
po për punët e shtëpisë. (Pamje I)*

I shoqi i Tanës, Vangjeli është tipi i burrit dembel, të cilin e godet Çajupi te vjersha “Fshatit tim”: ai nuk bën asnjë punë, po prehet nën hije, ndërsa e shoqja robtiset. Vangjeli i mban qëndrim të shoqes, kur ajo kërkon të martojë djalin, po mbas pak fjalësh mbyll gojën, mjafton që edhe Tana të mbyllë të sajën, të mos i lodhë veshët, ta lërë të flejë rehat:

*Moj grua, bën si të duash
dhe më qafë t’i kesh vetë! (Pamje I)*

e shkarkon vehten Vangjeli. Dhe Tana i përgjigjet:

Em këtu, em n’atë jetë!

Çajupi ka përshkruar më shumë realizëm jetën e fshatit, grindjet e grave për asgjë, fqinjë me fqinjë ose grindjen e grave në mulli, së fundi dasmën, ku ai s’ka munguar të vërë në lojë edhe një prift qejfii. Fundi i komedisë është i një komiciteti të madh: dhëndërrin e quan të shoqen, si edhe në këngën popullore, herë motër e herë nënë. E tërë pjesa shquhet nga gjuha e personazheve dhe shkathhtësia e dialogut. Duket sikur skenat kanë qenë të regjistruara drejt për së drejti nga jeta.

Me interes të veçantë është komedia në prozë “Pas vdekjes”. Sikundër na e mëson Çajupi vetë në dorëshkrimin e tij, pjesa është e përshtatur, s’dimë se nga cili autor. Po ajo u është përshtatur kaq mirë rrethanave të ambientit shqiptar, sa të duket origjinale. E shkruar më 1910, në kohën kur xhonturqit kanë treguar fytyrën e tyre të vërtetë, kur demagogjia e tyre ka dështuar, kur në atdhe kanë plasur kryengritje kundër Turqisë, e shkruar në atë kohë kur komedia e Çajupit ishte një vijim i plotësuar i fejtonit “Klub’ i Selanikut”. Ajo vinte në lojë veglat e xhonturqëve në Shqipëri, Mit-hat e Mehdi be Frashërin me shokë, si edhe ata që binin në grackën e propagandës xhonturke.

Personazh kryesor i komedisë është Doktor Adhamudhi, të cilin poeti e ka sulmuar shumë herë, dhe s’është veçse Dr. Adhamidhi, politikan shqiptar i kolonisë së Misirit, në fillim filogrek, pastaj me xhonturqit, ministër në qeverinë e parë të Durrësit, më 1914, etj. Çajupi ka personifikuar në të politikaxhiun sharlatan, mendjemadh e idiot, që është gati të ndërrojë flamur sa herë t’ia dojë interesi dhe megalomania. Ngjarjet zhvillohen në zyrën e gazetës “Liria”, në Klub të Selanikut.

Edhe pse Mitat Frashëri nuk del në skenë, vet fakti që autori i vendos ngjarjet në zyrën e tij, e lejon atë që ta paraqitë beun si prototipin e dallaveraxhiut e të servilit, që arrin gjer aty, sa nekrologjitë e njerëzve t'i bëjë gati përpara se këta të vdesin.

Çajupi në komedinë e tij vë në lojë edhe mikun e vet, patriotin Jani Vruho, drejtorin e gazetës "Rrufeja", ku ai pat botuar fejtonin "Klub' i Selanikut". Vruhoja si edhe Çajupi, kishte qenë kundër xhonturqëve dhe njerëzve të tyre, po nga frika se grindja që plasi midis shqiptarësh do të sillte një diversion të rëndë në lëvizjen kombëtare, ai u pajtua me Mitat beun dhe nisi të shkruajë në gazetën "Liria". Në tipin e gazetarit Vurko, Çajupi ka dhënë patriotin naiv, që gënjëhet nga propaganda xhonturke. Ai luan hollë me mikun e vet, duke e bërë të flirtojë në zyrat e gazetës me një mësuese shqiptare mendjelehtë, zonjzën Lulushe.

I krijuar veçanërisht mirë është edhe personazhi molieresk, shërbëtori i klubit, Zeneli, që i vërtit si do ai Adhamudhin, Vurkon e Lulushen, dhe i jep dorë autorit të krijojë çaste të një komiciteti të madh, siç janë veçanërisht ato kur, me anë të Vurkos, Zeneli shkruan nekrologjinë e Adhamudhit, në të cilën ky bëhet rezil, kurse për nekrologjinë e zonjzës Lulushe, Vurkoja, i dashuruar pas mësueses, përdor fjalët më të bukura. Këto nekrologji, të shkruara para vdekjes, Zeneli ua jep t'i lexojnë Adhamudhit e Lulushes për disa mexhide, dhe ata kështu ngopin kurizitetin duke mësuar se ç'mendojnë bota për ta. I një komiciteti të veçantë është çasti kur Dr. Adhamudhi lexon nekrologjinë e tij: nga inati, ai djeg një abetare' që kishte hartuar për t'u pëlqyer xhonturqëve, me të, shqipja shkruhej me gërma latine, po nga e djathta në të majtë! Adhamudhi pëlçet:

"Ah!... Prandaj shkrova këtë abetare! Për këtë qëllim!... Po nuk e botoj! Dreqi t'i marrë shqiptarët dhe shqipen!... S'e botoj, jo, kur s'ma dinë, kur më shajnë! Do të marr gjak!... Do ta djeg abetaren! (XVII)".

Komedia mbyllet me dashurimin e Vurkos me Lulushen. Te mësuesja, autori simbolizon vetë politiken demagoge të xhonturqëve. Fjalët që zonjzëa i thotë në mbarim të komedisë së Vrukos, këtë simbol zbulojnë:

Sot e tutje jam mikja jote! Oh, mike me të vërtetë! Mike për kokë!... Mike me mish e me shpirt!... Dhe të viç pa ndrrim, dhe të më këndoç vjershat e bukura që ke bërë për mua!

Këto vjersha s'janë tjetër veçse artikujt që Vruhoja ka nisur të shkrujë te gazeta "Liria". Të bukur flirt po bëni, kërkon t'u thotë Çajupi naivëve të politikës që nuk mungonin midis patriotëve të ndershëm të kohës.

Merita e veçantë e komedisë "Pas vdekjes" është se, me të, Çajupi inauguron në shqipet komedinë politike, pasi qe një iniciator me sukses i satirës politike në vjershë. Çajupi i jetonte gjallërisht e me pasion ngjarjet, ai kishte mprehtësi politike dhe, si armik i kompromiseve e i transigimeve, me armën e mprehtë të satirës së tij, poeti godiste drejt.

“Burr’ i dheut”, tragjedi e tipit klasik, me pese akte (pune) e në vargje (tetërokësh me rimë të puthur, si te Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr), e merr temën nga jeta e Skënderbeut, po duke mos i qëndruar fare besnik historisë. Poeti shkruan në parathënien e veprës: *“Është pun’ e ditur që, nga tërë djemt’ e Jani Kastriotit, ay m’ë i vogëli shpëtoi nga vdekja. Qysh shpëtoi Skënderbeu nga thonjt’ e sulltanit? Kjo vepër na rrëfen një mënyrë. Janë të vërteta? Kush e di!...”*.

Historia na tregon punët që kanë ngjarë vërtet. Për një tragjedi, punët që *mund të ngjajnë janë mjaft, si na thotë vetë Aristoteli. E di fort mirë që bir’ i Muratit II, quhej Muhamet, po un’ e quajta Selim dhe Muhametin e tregoj për të vëllan’ e sultan Muratit, se ky këmbim m’u duk i nevojshëm për fillin (trama)”*.

Në fakt, poeti shkoi edhe më tutje: nën Selimin, që s’di gjë për këtë, ai fshehu Skënderbeun, të cilin sulltan Murati e di se ka vrarë që foshnje. Skënderbeun e ka ruajtur e shoqja e Arianitit, e cila na paraqitet e martuar për së dyti herë me sulltan Muratin. Këto ndryshime kaq të mëdha që autori i ka bërë historisë janë tepër të papritura dhe, sado që thurja e dramës është e tillë që kërkon të mbajë gjer në fund të gjallë interesin, ky interes është i paktë për lexuesin. Kjo vlen edhe nga fakti se poeti nuk i ka paraqitur në mënyrë plotësisht bindëse ngjarjet.

Çajupi është përpjekur të krijojë karaktere heroike, si te Selimi (Skënderbeu). Fatimeja (e shoqja shqiptare e sulltan Muratit) dhe Mamica. Selimi është trim i rrallë, i urtë dhe i pa qartë; Fatimeja vepron trimërisht për të shpëtuar trashëgimtarin e fronit të Shqipërisë; Mamica është vajza sypatrembur, që nguron t’ia nxjerrë sulltanit në fytyrë gjithë vrerin dhe urrejtjen e saj.

Sulltan Muratin me të vëllanë e tij, Mehmetin, poeti i paraqet të egër, dinakë e të pabesë. Tiparet pozitive të krijuara nga Çajupi, kanë arritur prerjen e personazheve të tragjedisë klasike frënge, sidomos të atyre korneliane, që vënë detyrën mbi të gjitha. Po gjuha e tyre nuk është e zgjedhur; përkundrazi ajo është një gjuhë e thjeshtë popullore. Ndonjëherë ajo arrin të bëhet edhe vulgare, gjë që i shkon për shtat sulltan Muratit, të cilin poeti e paraqet si një lloj bishe.

Ka në tragjedinë “Burr’ i dheut” replica të qëlluara, pjesë me të vërtetë të bukura. Replica të tilla gjejmë, fjala vjen kur sulltan Murati mundohet t’i mbushë mendjen më të mira, por edhe me kërcenime Mamicës, që të martohet me Selimin.

Murati: *Nesër nisu ja për varr,
ja për martesë.*

Mamica: *Barbar, Mamica s’trëmbet të vdesë,
po s’do të tillë martesë.*

Murati: *Nesër shohmë...*

Mamica: *Ç’do të shoq?*

Murati: *Burr' a varr do të kërkosh.*

(Punë I, pamje III)

Bukur poeti ka paraqitur hamjet e bremjet e sulltanit, që nuk e di se cilin ka djalë, Selimin apo Musanë, cili prej tyre është Skënderbeu dhe cilin të vrasë:

O Zot, ç'është kshtu me mua!

Kë të vras e kë të dua?

Cili nga këta s'do t'anë,

se dy armiq më kanë!

Një prej ta më ka baba,

po kush është nga këta?

Mir' ay që s'më tregon,

po zëmra pse s'ma dëfton?

Kur thërres: Selim! Selim!

Rrrinë të dy në qetim;

pot ë thërres: Skënderbe,

nga të dy vallë kush je?

Më përgjigjen që të dy

dhe s'më shohnë dot me sy!

Nga këta djem, me një fjalë,

dy armiq kam, asnjë djalë!

(Punë IV, pamje IV)

Të bukura janë edhe stancat e Selimit, që të kujtojnë, si mjet artistik, stancat e Sidit të Kornejit. Edhe Selimi nuk e di mirë se është apo jo ai vetë Skënderbeu, me gjithë atë që flet me mall e dashuri të madhe për Shqipërinë:

Atdhe me male të naltë,

ti që më rrite që djalë,

dërgomë një grushtme baltë,

ta puth, të të kërrej mallë!

Ndë dhe të huaj, besomë,

zëmra fort m'u mallëngjye!

*Dërgomë një gur, dërgomë,
ta vë jastëk ndënë krye!*

Me tri veprat e tij dramatike, Çajupi dha një kontribut të mirë për fillimet e dramaturgjisë shqipe, duke rrokur qoftë temat aktuale, qoftë temën e Skënderbeut, aq të dashur për rilindësit. Ai na dha veçanërisht disa personazhe negative të qëlluara fort mirë, si Tana e Dr. Adhamudhi, pa harruar personazhin simpatik, shërbëtorin Zenel, që u vjen hakut dallkukëve e mëndjehtëve. Edhe përpjekja e tij për krijimin e personazheve pozitive të “Burr’ i dheut”, nuk është për të nënçmuar. Përpjekja e Çajupit për fillimin në shqipet jo vetëm të komedisë së shkurtër, ku ai pati sukses të plotë, po dhe të tragjedisë klasike, është një meritë e veçantë e krijimtarisë së tij.

KREU I: Jetëshkrimi dhe vendi i tij në letërsinë e Rilindjes

Kombëtare

1.1 Vendi i Çajupit në letërsinë shqipe

Që në fillim të kësaj çështjeje na lind pyetja se çfarë rrjedhimesh pati paravësia e Shqipërisë mbi letërsinë?

Në fillim nuk pati kurrfarë rrjedhimi. Dhjetëvjeçari i parë i pavarësisë nga shpallja në Vlorë më 1912 e deri në daljen e Ahmet Zogut në fillim të viteve njëzet u shënua nga trazira politike të skajshme, nga gjakderdhje e vuajtje. Qëllimi politik zyrtar i lëvizjes kombëtare, d.m.th, pavarësia, ishte arritur, e ndërsa shqipja ishte bërë gjuhë zyrtare në vend, rrëmuja e vazhdueshme politike u jepte shkrimtarëve dhe intelektualëve brenda vendit tepër pak kohë për të përsiatur përmasat e reja të kulturës kombëtare.

Andon Zako Çajupi është shkrimtari që jetoi në kapërcyell të dy kohërave; ai jetoi, nga njëra anë, kohën historike të Rilindjes dhe kohën historike të fillimeve të shtetit të pavarur shqiptar dhe, nga ana tjetër, kohën letrare të romantizimit dhe kohën letrare të fillimeve të realizmit në letrat shqipe¹.

Kultura e romantizimit kombëtar të Rilindjes, e rrënjosur thellë në letërsinë shqiptare, jo vetëm që vazhdoi të ndihet, por edhe të ndikojë gjatë gjithë periudhës së pavarësisë. Vazhdimësia e ideve dhe aspiratave të shprehura në shkrimet shqipe do të arrinte brenda pak kohe një nivel shumë më të lartë artistik nga çfarë ishte arritur ndonjëherë në letërsinë e Rilindjes në fund të shekullit të XIX.

Vendi i Çajupit në historinë e kulturës shqiptare, si një shkrimtar që, nga një anë, shprehu mendësinë e Rilindjes dhe, nga ana tjetër, e tejkaloi atë, lidhet dhe me një aspekt tjetër të veprës dhe të personalitetit të tij².

Të shkruarit në shqip pushoi së qeni thjesht një akt atdhetarie kundër imperializmit kulturor të huaj, dhe intelektualët shqiptar filluan, ndoshta për herë të parë, të shohin se mundësitë e zhvillimit letrar e kulturor ishin të pakufizuara. Institucionet shkollore katolike të ngritura në gjysmën e dytë të shekullit të XIX nga françeskanët dhe jezuitët në Shkodër dhe pas pavarësisë shkollimi në gjuhën shqipe në mbarë vendin, kishin çarë rrugën për krijimin e një elite në Shqipëri. Ato dhanë frytet e veta në vitet njëzet.

Letërsia e krijuar nga kjo shtresë intelektualësh të shkolluar në gjuhën dhe kulturën e tyre u shpreh përsëri kryesisht në poezi, ndonëse praktikisht u shfaqën të gjitha gjinitë letrare. Periudha e pavarësisë dëshmoi lindjen e tre poetëve, krijimtaria e të cilëve pasqyron fuqishëm vazhdimësinë e

¹ Jorgo Bullo, *Andon Zako Çajupi, koha dhe vepra e tij*, në: "Kërkime universitare" nr. 7, Universiteti i Gjikokastrës "Eqrem Çabej", revistë shkencore periodike, Tiranë, 2003, f. 8.

² Jorgo Bullo, *Andon Zako Çajupi, koha dhe vepra e tij*, në: "Kërkime universitare", nr. 7, Universiteti i Gjikokastrës "Eqrem Çabej", revistë shkencore periodike, Tiranë, 2003, f. 9.

kulturës së Rilindjes. Ata ishin Andon Zako Çajupi në Egjipt, Ndre Mjeda në Shkodër dhe Asdreni në Rumani.

Çajupi rinovoi një traditë letrare dhe krijoi një traditë të re. Vepra e Çajupit nuk është një hallkë që lidhë epokën letrare të Rilindjes me atë që erdhi pas saj, por një faktor i progresit artistik të letërsisë shqiptare, në fazën e kapërcimit nga romantizmi në realizëm, nga patosi afirmativ kombëtar e patriotik, në patosin social kritik. Ky ishte një hap i madh që e integronte letërsinë shqiptare në rrjedhat moderne të zhvillimit të letërsisë ballkanike dhe evropiane të kohës³.

Etapa më e rëndësishme e veprimtarisë letrare e kombëtare e Andon Zako Çajupit është nga 1898 e deri më 1912. Më 1902 ai ishte anëtar dhe veprimtarë i vëllazërisë së shqiptarëve të Egjiptit dhe po atë vit botoi vëllimin me poezi për të cilin ka mbetur i mirënjohur “Baba Tomori”, Kajro 1902. Kjo përmbledhje, me emrin e malit Tomor, Parnasi i mitologjisë shqiptare, përmban lirika, shumica me tema atdhetare, dhe ndahet në tre krerë:

1. Atdheu,
2. Dashuria,
3. Përralla të vërteta e të rreme.

Suksesi që i menjëhershëm. As edhe një përmbledhje tjetër me poezi shqiptare nuk që bërë kaq popullore ndër shqiptarët brenda e jashtë vendit që me përmbledhjet e Naim Frashërit.

Vepra e Çajupit nuk evokoi thjesht atdheun historik, të imagjinuar ideal prej shqiptarëve, por i këndoi “dheut ku u kishte rënë koka”, ku vuanin e gëzoheshin dhe ku vetë poeti ëndërronte t’i preheshin eshtrat⁴.

Çajupi nuk u mjaftua me mallin romantik të poetëve të mëparshëm të mërgimit si Filip Shiroka. Sigurisht që ai ishte një nacionalist, por ai ishte edhe i vetëdijshëm për realitetin e zyrtë të jetës në atdhe. Një nga baladat më të spikatura në këtë përmbledhje, “Fshati im”, ka në qendër për shembull pabarazitë në shoqërinë patriarkale:

*“Maletë me gurë
Fusha me bar shumë,
arat me grurë,
me tutje një lumë”...*

³ Jorgo Bullo, *Andon Zako Çajupi, koha dhe vepra e tij*, në: “Kërkime universitare”, nr. 7, Universiteti i Gjikokastrës “Eqrem Çabej”, revistë shkencore periodike, Tiranë, 2003, f. 9.

⁴ Jorgo Bullo, *Andon Zako Çajupi, koha dhe vepra e tij*, në: “Kërkime universitare”, nr. 7, Universiteti i Gjikokastrës “Eqrem Çabej”, revistë shkencore periodike, Tiranë, 2003, f.9.

Edhe pse ky vëllim poetik ishte më i rëndësishmi i viteve të para të shekullit të njëzetë, Baba Tomori nuk ishte i vetmi botim i Çajupit. Çajupi s'ishte aspak poet modern. Welteanschung'-u i tij ishte i lidhur me luftën e lëvizjes kombëtare dhe me kulturën e Rilindjes. Njëkohësisht, nëse krahasojmë vargun e tij me atë të Naim Frashërit, do të vëmë re një evolucion të qartë. Ky hap përpara drejt një kulture sovrane për një komb sovran⁵.

Është një përmbledhje lirikash e satirash, ku Çajupi futi edhe komedinë me një akt e në vargje "Katrëmbëdhjetë vjec dhëndërr". Këtyre vjershave ne mund t'u shtojmë edhe ato pak, që poeti botoi veç e veç më pas, pa ia ndërruar frymën dhe fytyrën librit. Vetë Çajupi e ka ndarë veprën në tri pjesë, sipas motiveve që ai trajton: "atdheut", me lirikat e satirat patriotike; "dashurinë", me erotikën, "përralla të vërteta dhe të rreme", me motivet shoqërore.

"Motive patriotike" në parathënien e Dramës "Burr' i dheut," më 1908, poeti shkruante: "Për të fortësuar ndjenjat kombëtare dhe dashurinë ndërmjet neve, për të ndarë fenë nga kombësia, për të përhapur shqipen që ka mbetur kaqë pas, për të gatitur, me një fjalë, udhën e lirisë, të tilla vepra kanë sidomos një dobi, një rëndësi. Si thashë edhe kur botova "Baba-Tomorrë", çdo shqipëtar duhet të punojë për këtë qëllim të shënjtë". Me këtë program luftarak e nisi dhe e vazhdoi krijimtarinë e vet Çajupi.

Ai u nis së pari nën ndikimin e Naimit, ndikim që shihet në tematikën e vjershave si "trim'i Shqipërisë", "dëshir' e Skëndebeut ditën që vdiq". Këto edhe ndonjë tjetër, janë pa dyshim ndër krijimet e para shqipe të Çajupit, sepse dëshmojnë për një farë pasigurie pune, e natyrshme në fillimet e çdo artisti. Po aty diktohet menjëherë talenti i ri, veçanërisht përmes fytyrës së poezisë popullore, që do të mbetet prej tipareve kryesore të veprës së tij poetikë.

I ushqyer nga vepra e fundit e Naimit, "Histori e Skënderbeut", (1898) dhe nga "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e çdo të bëhetë" (1899) e Samiut, në një kohë kur çështja e çlirimit të vendit po fillon të shtrohet me forcë. Çajupi e shpall në vargjet e tij në mënyrë krejt të papërmbajtur urrejtjen kundër pushtuesit, nevojën e domosdoshme të çlirimit, duke lëshuar haptazi parullën e luftës së armatosur: Ja të vdesim, ja të rrojmë, për liri (Shqipëria).

Si dhe Samiu më 1899, Çajupi nuk nguron aspak ta paraqesë gjendjen e vendit, ashtu siç është, në mënyrë të fortë realiste:

Sot qysh gjëndet Komb' i Shqipërisë?

I përmbysur nga zgjedh' e Turqisë.

Shqipëtarët, si dhe bagëtia,

⁵Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001.

*Zbathur, zveshur, vdesin nga uria!
Shqiptëraët?-Sot s'ka shqipëtarë:
Turku, greku na kanë përndarë!
Prifti, hoxha, kasha dhe xhamia
na gënjejnë... U prish Shqipëria.
(Baba-Tomorri)*

Përpara gjendjes akoma të dobët të lëvizjes kombëtare, gjendje për të cilën Samiu pati folur aq shprehimisht, poeti nuk nguron ta ngrejë kështu fort zërin dhe të kërkojë t'i prekë bashkëatdhetarët thellë në sedrën e tyre: Sot s'ka shqipëtarë! Gjetiu, duke plasur nga marrazi që akoma lëvizja kombëtare s'ka marrë zjarrin e duhur, sarkazmën e tij ndaj pushtuesit Çajupi e kthen së fundi kundër asaj lëvizje, duke i vënë sulltanit në gojë fjalë të tilla:

*S'më bën dot gjë shqipëtari.
Dhe sa të jem vet' i gjallë,
nga zgjedha s'ka për të dale.
(Sulltani)⁶.*

Më rëndësi është fakti se Çajupi e fton popullin shqiptar të rrëmbejë armët, dhe te vjershat "Korriku" (1903) i jep atij si shembull luftën e popullit frëng gjatë revolucionit borgjez të 1789-s. Duke simbolizuar me muajin korrik kohën e punës e të revolucionit, Çajupi, si dhe Mjeda te "Liria", çlirimin prej Turqisë nuk e përfytyronte dhe nuk e sheh si një çlirim të thjeshtë: ai shpresonte se bashkë me shporrjen e feudalëve të huaj, në Shqipëri do të krijoheshin kushtet për një regjim demokratik të tipit borgjez, do të krijoheshin mundësia veçanërisht që fshatari të merrte tokën nga feudalët.

Me poezinë e tij të flaktë luftarake, Çajupi u bënte ushëtimë ndjenjave të kryengritjes që po vëlonin në Shqipëri. Poezia e tij ishte e tërë një grishje për luftë të armatosur dhe paralajmëronte lëvizjen relovucionare që plasi menjëherë, me çetat e para të lirisë dhe kryengritjet (1905-1912).

Si dhe rilindësit e tjerë, rrezikun më të madh të Shqipërisë Çajupi nuk e gjente vetëm te sunduesi, po edhe te përçarja e vendit, te papjekuria dhe dobësia e lëvizjes kombëtare. Shkakun e madh të kësaj përçarje, poeti e shihte në radhë të parë te fetë.

Një nga vjershat më interesante të Çajupit, është ajo si baladë, e mbështetur në epikën popullore legjendare, "Atdheu dhe dashuria", temën e së cilës e pamë se e shfrytëzoi përpara tij shkrimtari

⁶ Historia e letërsisë shqipe, I, II, Prishtinë, 1968, f. 554-555.

tjetër i Misterit, Th. Krei. Një ushtar turk kërkon të rrëmbejë gruan e një shqiptari; trimat hidhen në dyluftim dhe, nga hajmalitë që kishin në qafë, njohin njeri-tjetrin: të dy janë vëllezër; i pari ka humbur që i vogël, siç duket i marrë nga turqit e i bërë jeniçer; të dy vëllezrit betohen se tani do të luftojnë kundër armikut të përbashkët, Turqisë. Është tema e vëllavrasësit dhe e rinjohjes vëlla më vëlla, të cilën Çajupi e ka ndryshuar, duke i dhënë një përfundim të mirë. Nuk është e para herë që poeti do ta marrë temën e tij nga folklori⁷.

Në një tjetër vjershë, "Vaj", Çajupi tregon se si shqiptarët venë e vriten për të huajt, për Turqinë dhe Greqinë, kurse për vendin e tyre të robëruar ata akoma nuk po bëjnë gjë. Shqipëria, e personifikuar në fytyrën e një nënë, qan me dhimbje e pikëllim të madh të birin që iu vra për të tjerët.

*Sos lëftonte Shqipëria,
që nxive ditët e mia..
Vajte lëftove për botë,
u mundove dëm e kotë!
Bir, o djal'i vetëmë,
se ç'më nxive jetënë!*

Mërinë e tij kundër Turqisë, Çajupi e ka shprehur përmes një satire shumë të fortë në vjershën "Punërat e Perëndisë". Aty poeti, që gjetiu thotë se ka rrespekt me Perëndinë, qesëndis keq edhe me të, aq e papërmbajtëshme është urrejtja e tij kundër vetë ekzistencës së Turqisë. Perëndia ka bërë shumë të mira mbi dhe, e poeti i numuron me radhë, gjatë. Pa pritur, pëlçet sarkazma:

*Bëre dimër, e beharë,
berë kuaj dhe gomarë,
bërë misër edhe grurë,
po më shumë bëre gurë.
Si bëre kaqë të mira,
bëre dhe shum' egërsira.*

Këto janë ariu, dreri e djalli me brirë. Po egërsira më e madhe që paska bërë Zoti, është vetë Turqia:

*Kur berë derr' e arinë,
ç'deshe që berë Turqinë?*

⁷ Historia e letërsisë shqipe, I, II, Prishtinë, 1968, f. 556.

Ka në këtë vjershë një protest të madhe jo vetëm kundër pushtuesit barbar, po mund të thuash kundër vetë gjendjes shoqërore të botës së “krijuar”, ku ekziston shtypja më mizore e popujve, si në Shqipëri.

Në një tjetër vjershë satirike po kaq të fortë, “Sulltani”, poeti karikaturon Abdyl Hamitin II në trajtat e një përbindëshi që rrënon vende e zhduk popuj, që rron me historinë e krimit dhe dridhet për vetë ekzistencën e vet të ndyrë: sulltani ka aq frikë nga njerëzit, sa do t’i pëlqente t’i shuajë të tërë, që të mund të rrojë pastaj me egërsirat, me te cilat merret vesh.

*Pse s’u bë nga Perëndia
më një kokë njerëzia,
që ta presë menjëherë?
Të mos mbeteshin të tjerë!
Të mbetej dheu i shkretë,
se doje të rrojë vetë;
me egërsira të rrojë,
pa frikë të mbretërojë⁸.*

Çajupi është një ndër ata që kanë bërë luftën më të ashpër kundër shovinizimit grek në letërsinë tonë të Rilindjes.

Midis vjershave të tjera patriotike të Çajupit, janë ato ku poeti i këndon vendlinjes. Ai i këndon atdheut si një fshatar i thjeshtë, plot mburrje që është shqiptar e me dëshirën e zhuritur që këtu të vijë e t’i mbarojë ditët:

*Në ç’vënd kemi lerë?
Ku na bëjnë nderë?
Në Shqipëri.
Po njeriu vetë,
cinë do në jetë?
Do vënd e ti.
Ku i duket balta
m’e ëmbël se mjalta?
Në Shqipëri.
Ku rron me një shpresë?
Ku kërkon të vdesë?*

⁸ Historia e letërsisë shqipe, I, II, Prishtinë, 1968, f.557.

Në vënd' e ti.

(Ku kemi lerë).

Poezia patriotike e Çajupit kap gjithë motivet që kishte trajtuar poezia jonë patriotike e gjysmës së dytë të shekullit XIX, po me një forcë të re. Dhe ky është një nga tiparet kryesore të kësaj poezie, me të cilën sillet shekulli i ri i poezisë shqiptare. Fryma popullore që atë e përshkron në brendi dhe formë, e bën vjershën e Çajupit, të rrëmbehet menjëherë nga lexuesit. Ndjenjat antifeudale që nisin të zënë vend nëpër vargjet e tij, çojnë më tej lirikën patriotike shqiptare dhe e bëjnë këtë një poezi me një përmbajtje demokratike.

Përpara Çajupit, erotika zë një vend fare të vogël në poezinë shqiptare të Rilindjes, kryesisht përmes vargjeve të Naimit, kurse tek arbëreshët e Italisë ajo është në qendrën e tematikës. Mund të themi se pjesa më e madhe e vjershave të Çajupit i përket dashurisë. Ai i kushtoi pjesa më e madhe e vjershave.

1.2 Vendi i Çajupit në historinë e kulturës shqiptare

Veprimtaria letrare – Në letërsi Andon Zako mori edhe llogarin “Çajupi”, sipas emrit të një mali të vendlindjes së tij. Duke jetuar jashtë atdheut dhe duke u shkolluar në gjuhën e greke dhe franceze, nuk mundi ta mësojë gjuhën amtare letrare, kështu që në fillim i vinte vështirë të shkruajë në gjuhën e vet.

Çajupi jetoi dhe krijoi në një periudhë të rëndësishme të historisë së popullit tonë dhe të zhvillimit të letërsisë shqiptare. Ai qe bashkëkohës i disa ngjarjeve historike me rëndësi për fatet e kombit. Fundi i shekullit të XIX dhe fillimi i shekullit XX deri në vitin 1930, kur vdiq Çajupi, ishte periudha kur shoqëria shqiptare duhej të zgjidhte disa detyra historike; të shpëtonte nga zgjedha e gjatë e sundimit osman, të fitonte Pavarësinë Kombëtare dhe të hynte në udhën e zhvillimit demokratik. Çajupi me veprimtarinë dhe krijimtarinë e tij letrare iu përgjigj këtyre detyrave⁹.

Përndryshe, ai fillon të shkruajë shumë herët. Prandaj shkrimet e tij të para janë në gjuhën frënge ose greke. Më vonë, i frymëzuar nga Rilindja e popullit shqiptar, e mësoi mirë gjuhën amtare, kështu që prej vitit 1898 fillon të shkruajë edhe në gjuhën shqipe. Çajupi shkroi mjaft vepra letrare. Deri më tani dimë se shkroi 27 sosh, por nuk u botuan të gjitha sa qe gjallë poeti. Ai e pasuroi letërsinë shqipe jo vetëm me vepra origjinale, por edhe me përkthime nga frëngjishtja. Nga veprat letrare origjinale në radhë të parë duhet përmendur: “Baba Tomorri”, “Burri i dheut”, “Pas vdekjes”, “Dhjatë e vjetër” etj, kurse nga përkthimet: “Përralla” nga La Fonteni, si dhe “Lulet e Hindit”, poezi sanskrite e adaptuar nga gjuha frënge. Dihet se Çajupi shkroi tri përmbledhje poezish. Deri më tash u

⁹ Floresha Dado, *A.Z. Çajupi jeta dhe vepra*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 7.

botuan vetëm dy, kurse e treta ngeli e pabotuar. Po ashtu shkroi katër drama, por drama e tij “Detyra” nuk dihet se çka u bë.

Nga frëngjishtja përktheu dy libra fabulash dhe poezish. Sipas vlerësimit të përgjithshëm vepra e tij origjinale më e mira mbetet “Baba Tomorri”. Kjo vepër u botua katër pesë herë deri tash. Për herë të parë “Baba Tomorri” e botoi vetë shkrimtari, në Kajro në vitin 1902. Botimi i dytë u krye më 1935 në shtypshkronjën “Gutenberg” në Tiranë, dhe përsëri pa datë të qartë në vitet 30-ta, në shtypshkronjën “Dhori Koti” në Korçë.

Botimi i katërt, por jo i plotë, u krye nën redaktimin e Dh. Shuteriqit, në Tiranë më 1950, dhe i fundit botim, i pesti e gjejmë në përmbledhjen e veprave me titull “Çajupi – Vepra”, Tiranë, 1957. Përveç botimit të vitit 1950, i cili nuk përfshin disa vjersha, të gjitha botimet tjera janë të njëjta. Sipas pjesëve përbërëse që janë përfshirë në këtë vepër, intonacionet liriko-satirike, ashtu siç i ka parashtruar vetë autori, ato i kushtohen “Atdheut”- vjershat patriotike, “Dashuria”- vjersha dashurie dhe “Përralla të vërteta e të rreme”- me motive shoqërore, në këtë përmbledhje gjendet edhe komedia një aktëshe “Katërmëdhjetë vjeç dhëndër”, këto vjersha i përkasin programit të Rilindjes kombëtare. Sipas shembullit të mirë të paraardhësve të tij veçanërisht të vëllezërve Frashëri. Naimit e Samiut, të cilët qysh para tij, e kishin caktuar drejtimin e programit të Rilindjes shqiptare, dhe sipas atmosferës së përgjithshme në radhët e emigracionit shqiptar në Ballkan e në Egjipt.

Andoni është një nga mbajtësit e synimeve patriotike për Rilindjen kombëtare. Në të vërtetë, në fillim nuk ishte krejt i sigurt në rrugën e tij, sepse ishte nën ndikim të madh të Naim Frashërit dhe të folklorit, por më vonë, i prirur nga gjykimi i tij i shëndoshë dhe i ndjenjave patriotike, e i pajisur me kulturë perëndimore, i tejkalon mësuesit e tij¹⁰.

Prandaj Çajupi, nga kjo fazë e dytë e zhvillimit, bëhet kundërshtar i rreptë e i pa kompromis i pushtuesit turk, dhe na bën të qartë se ishte e domosdoshme që të çlirohet populli dhe vendi i tij nga robëria otomane me parullën:

Ja të vdesim, ja të rrojmë, për liri!

Ai bën një hap më tutje, duke treguar gjendjen e vendit ashtu siç ishte me të vërtetë e duke klithë:

Sot qysh gjëndet Komb'i Shqiprisë?

I përmbysur nga zgjedh'e Turqisë.

Shqiptarët si dhe bagëtia,

zbathur, xhveshur, vdesin nga uria!

Shqiptarët ? – Sot s'ka Shqiptarë:

Turku, Greku na kanë përndarë!

Priifti, Hoxha, kasha dhe xhamia

¹⁰ Andon Zako – Çajupi, *Vepra*, Rilindja, Prishtinë, 1963.

na gënjejnë... U prish Shqipëria ! ...

(Baba - Tomorri)

Çajupi bëhet një ndër iniciatorët e drejtpërdrejtë të luftës që ta tronditë çdo Shqiptar, që do të zgjojë te ai ndjenjat e flakta patriotike, që lëvizja çlirimtare të shpërthejë deri te shtresat më të larta, duke ndikuar në anët më të ndjeshme të popullit, ai tregon se, ç'mendon sulltani i Turqisë për Shqiptarët:

*S'më bën dot gjë Shqiptari,
Dhe sa të jem vet'i gjallë,
nga zgjedha s'ka për të dale.*

(Sulltani)

Por Çajupi nuk ndalet këtu, ai e thërret drejtpërdrejt popullin që, me armë në dorë dhe me besën e lidhun, t'i dëbojmë Turqit nga vendi i tyre (Besa-Besë), dhe ta çlirojnë atdheun:

*Çvish rrobat e robërisë, mëmëdhe,
vesh armët e Trimërisë se ke ne!*

(Shqipëtar)

Ose si refren i vjershës "Trimi i Shqipërisë":

*Të ngiremi të lëftojmë,
Turqit këtejë t'i dbojmë,
Shqipërinë ta shpëtojmë,
dhe t'liber e me nder' të rrojmë.*

Sepse Çajupi mendon se Shqiptarët luftojnë dhe vdesin edhe për Turqinë edhe për Greqinë, e për vehte dhe popullin e tyre nuk mendojnë fare:

*O Shqipëtarë të mjerë,
ç'u ka marrë koka erë,
derthni gjaknë për të tjerë!
Gjithë trimat e Turqisë,
janë djemt e Shqipërisë,
ata që bënë Morenë,
gjithë Shqipëtarë qenë.*

Megjithatë, Çajupi nuk humb shpresën, ai e parasheh rrugën e shpëtimit të popullit dhe të atdheut të vet. Dashuria e tij ndaj atdheut të vet është e pakufishme, sepse ai e do edhe ashtu siç ishte, por të lirë do ta donte edhe ma tepër:

*E dashura mëmëdhe,
të dua dhe kshtu si je!
Po kur të të shoh të lirë,
do të të dua më mire.*

(Robëria)

Siç kemi pa deri këtu, ndjenjat e tij patriotike gufojnë me një fuqi të pafrenueshme. Kështu në vjershën “Atdheu e dashuria” dy motive deri diku të ndryshme, tregojnë se edhe në këto gjëra, po të shikohen pak më hollësisht, nën hirin e robërisë zbulohet si ndonjë feniks i vërtetë i dashurisë vëllazërore. Çajupi e ngre zërin kundër hakmarrjes shqiptare, që është si fryt i jetës së popullit nën robëri, për të cilën ai gjen një zgjidhje të mirë “Pajtimin”. Ky motiv është i njohur në poezinë popullore e madje edhe i botuar nga (Q. Haxhihasani: *Kangë popullore legjendare*, Tiranë, 1955, faqe 69-77), por Çajupi e përpunon dhe krijon një lloj balade artistike epiko-kreshnike.

Ai këtë e shfrytëzoi në momentin e përgatitjeve të mëdha të të gjithë popullit për luftën e përbashkët për çlirimin e vendit nga zgjedhja e robërisë. Poeti mendon shumë mirë dhe në mënyrë reale: se është e pa themel me menduar për fitoren e popullit, nëse nuk janë pastruar mendimet e vëllavrasjes. E kur kërkon arsyet e kësaj gjendje të popullit, poetit pa rezervë i kujtohet fajtori kryesor, i kujtohet regjimi feudal i Turqisë. Ai është fajtor për çdo gjë të keqe që e ka gjetur popullin shqiptar. Prandaj në vjershën e tij satirike “Punërat e Perëndisë” shpërthen i gjithë mllefi i tij kundër Turqisë.

*Bëre... Po ç'nuk ke bërë
Bëre botënë të tërë.
Bëre dhe djallë me brirë!
Çdo pun'e ke bërë mire,
Po një gjë bëre pa mënde
dhe prishe punënë tënde:
kur bëre derr'e arinë,
ç'deshe që bëre Turqinë?
Se të mos qënkej kjo fare,
bota do të vintej mbarë,
(Punërat e Perëndisë)*

Me këtë poezi Çajupi na paraqitet si satirik. Ndonëse satira e pendës së tij është mjaft e ashpër sa kalon në sarkazëm për kohën e vet tregon një fillim të mirë në krijimin e satirës në letërsinë shqipe. E ngjashme me “Punërat e Perëndisë” është dhe vjersha “Prishj’e lëkursit nga Greku”, në të cilën e sulmon Greqinë që dëshironte ta shfrytëzojë për qëllimet e veta lëvizjen popullore në kohën e Lidhjes së Prizrenit (1878). Andaj Çajupi i shpall luftë të rreptë shovinizmit grek.

Shkrimtarët shqiptarë të Rilindjes para tij, përpos Naim Frashërit, fare pak ndaleshin te ndjenjat e dashurisë, ndërsa Çajupi në këtë pikëpamje gati i kalon edhe arbëreshët e Italisë. Është e njohur se ai i adapton edhe vargjet e poetit latin Tribulit, por këto tingëllojnë si me qenë origjinale. Kurse në poezitë e tij erotike origjinale, Çajupi kultivon ndjenjat e përjetimeve të veta intime. Kujton Marën, shoqen e dikurshme të fëmirisë, të cilën prindërit e kishin fejuar. Kundër kësaj si dhe kundër prapambetjeve të tilla shoqërore, ai do ta ngrejë zërin në “Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr”. Por për dashurinë e parë, për Marën e fëmirisë, ai shpreh një sinqeritet si të ishte fëmijë:

*E mba mënt, moj Marë,
dashurin' e parë?
Nnjeri nuk e gjegji,
se jeshmë të vegji.
Unë pa ty s'rrojë,
vij' e të kërkojë,
ti pa mua s'rroje,
vij' e më kërkoje.*

Siç duket nga vjersha, këtu është treguar një kujtim nga ditët e fëmirisë, kur “I fejuemi” i pavetëdijshëm jetonte pranë “të fejuemës” së vet, është dhënë jeta reale dhe pa brenga e fëmijëve, të cilët do të bëhen “bashkëshortë”, por:

*Një ditë, të dyza
losnim mbyla-syza;
u fshyem pa dukur
në ferra, në gurë,
u fshem kaqë bukur,
sa s'u gjëntm dot kurrë....*

Tregon në mënyrë edhe simbolike edhe reale “*se u fshenë kaqë bukur, sa s’u gjëtn’ më kurr’*”. Ky është realiteti dhe e reja, që solli Çajupi në letërsinë shqipe, sepse ne e dimë se ai, me të vërtetë, shumë i ri u nis për në vend të huaj, në Egjipt, dhe kështu, siç thotë në këngë, më kurrë nuk e takoi Marën. Këto ndjenja intime e personale, Çajupit i shpërthejnë edhe kur këndon për humbjen e pikëllueshme të bashkëshortes së tij të dashur. Siç e dimë, gruaja i vdiq menjëherë mbas lindjes së djalit të parë e të vetëm, Stefanit. Ky është *vajtimi i babës së lanun me fëminë pa nanë*. Dhimbjen që po e ndien edhe mbas dhjetë vjetësh, e shfaq në elegjinë:

*Që ditën që vdiqe, që kurr s’të kam parë.
Lotë që kam derdhur s’më janë dhe tharë!
Shumë vjet u bënë, sot u mbushnë dhjetë,
që kur më ke lënë dhe s’të sho ndë jetë!
Ndë ç’kopshte me lule ke qëndruar vallë?
S’të vjen keq për mua? S’të vjen mall për djalë?
O engjëll i bukur, mos mëno në botë,
ktheu të të shomë, të na mbetën lotë.*

(Vaje)

Si në këto, ashtu edhe në vargjet tjera, që i përshkon një dhembje e pikëllim i madh, nuk e ndeshim ndjenjën dhe idenë pesimiste. Më vonë, në pozita tjera, poeti merr e trajton motivet e problemet e botës “së pasur e të varfër” i urren njerëzit që lakmojnë të hollat dhe lufton kundër eksploatorit, kundër Turqisë feudale. Optimizmi i tij del nga besimi i thellë, se ditë të mira popullit të tij do t’i vijnë patjetër, porsa të çlirohet vendi nga robëria e huaj. Prandaj edhe në vjershat e tij të mërgimit shfaqet afshi i dashurisë ndaj atdheut. Me motivet mbi mërgimin, paralajmëron edhe lirikën e thjeshtë shoqërore.

Motivet shoqërore – Në këtë lloj të poezisë së Çajupit, gjen shprehje humori i bukur, si dhe erotika, vjershat satirike-sarkastike e patriotike. Këtu në radhë të parë i qëllon zakonet e prapambetura katundare të vendlindjes së vet. Sidomos tehun e mprehtë satirik të tij e drejton kundër burrave, të cilët të gjitha punët e rënda të shtëpisë dhe të katundit i lanë pa mëshirë mbi kurriz të grave:

*Gratë në të shire,
në të vjela, gratë,
ikinë, pa gdhirë,
kthehenë me natë.*

*Gruaja për burrë
digjet në diell,
punon e s' rri kurrë
as ditën e diel.
(Fshati im)*

Një problem kryesor Çajupi e sheh në gjendjen e vështirë familjare të mërgimit. Për shkak të vështirësive ekonomike në atdheun e robëruar, meshkujt me shumicë shkojshin si punëtorë krahu jashtë atdheut, që të fitojnë bukën. Kjo ishte një fatkeqësi e madhe për familjet shqiptare. Poezija popullore shekuj me radhë këndon për ngjarjet tronditëse të kësaj jete. Edhe vetë Çajupi mundohet t'i shërojë plagët e kësaj fatkeqësie shoqërore.

*Mitrua, kur u martua,
ndënji një muaj me grua!
erdhi dita për të ndarë
dhe u ndanë duke qarë!
E zeza grua se ç'hoqi!
Humbi shpresën tek i shoqi;
kur pa ngrënë' e kur pa pirë,
punoj e rriti të birë.
Lum kush rron në vënd të ti,
me qe, me dhën e me dhi,
Mos u ndani nga shtëpia,
të mos mpshojë Perëndia,
se Perëndia kur mpshon,
gjynahqarët i mundon.*

Mbas njëzet vitesh, Mitrua kthehet në katundin e vet, në shtëpi me mjaft fitime. Mirëpo, duke ardhur rrugës mendonte gjithçka:

*„Në gjeça shtëpinë bosh?
Në mos e gjeça të gjallë, gruanë ! “...*

Me mendime të këtilla e më të zeza, ai i afrohet shtëpisë së vet dhe nga dritarja sheh se nana përkëdheli të birin, mbasi Mitrua nuk e dinte që ka një bir njëzetvjeçar, mendoi se gruaja po përkëdhelte ndonjë dashnorë të vet.

*“Obobo! Sytë ç’më panë!
Tha Mitrua si i marrë.
Pashë gruan me jaranë!
Po tani do t’ju bëj varrë!
Do t’u bie me kobure,
t’i lëshoj në shesh shondure,
Mua të më venë brirë!
tha, edhe goditi të birë!
Mem’e zezë ulëriti,
pushtoi djalën dhe briti;
puçka krisi dhe një herë,
ra përmbys dhe mën’e mjerë!”.*

Duke treguar ngjarje të këtilla, jo vetëm ai që mundohet ta shërojë këtë plagë të popullit të vet, por edhe por edhe vetë populli këndonte këngë vajtimi për kurbetin, për plagën e rëndë, e cila e mjeronte shtëpinë dhe shoqërinë shqiptare. Në lirikën e tij shoqërore, Çajupi kritikon, jo vetëm kurbetin, por edhe martesën me të holla, dukuri jo e shëndoshë dhe e natyrshme, si edhe kryeneqësitë, e madhështinë etj. Në këtë pikëpamje Çajupi shkon edhe më tutje, ngre zërin edhe kundër kolonizatorëve (Anglezëve dhe Francezëve). Krejt padrejtësinë e shoqërisë e akuzonte rreptësisht.

1.3 Vendi i Çajupit në koloninë shqiptare të Egjiptit

Andon Zako Çajupi u vendos në Misir në vitet 1894-1895, ku gjeti një mjedis shqiptarësh dhe një lëvizje patriotike të nisur kaherë. Patriotët e Egjiptit i kishin nisur përpjekjet për t’u organizuar në shoqëri që nga fundi i shekullit XIX.

Pjesën më të rëndësishme të krijimtarisë artistike të Çajupit e përbën poezia. Ajo e bëri autorin menjëherë të njohur në popull dhe në rrethet letrare shqiptare, brenda dhe jashtë atdheut. Vëllimi “Baba Tomorri”, në poezitë e të cilit mendimi dhe ndjenja harmonizoheshin dhe plotësonin njëri-

tjetrin, i siguroi Çajupit edhe në ditët tona një popullaritet të tillë, që pothuajse nuk e gëzoi asnjë autor tjetër, veç Naimit¹¹.

Në vitin 1869 Dora D'Istria i shkruante De Radës: "Në Egjipt... ku shqiptarët gëzojnë një influencë të madhe, gjenden shumë patriot që interesohen për ditë e më shumë për fatet e kombit".

Në vitin 1882 Jani Vreto krijoi degën e "Shoqërisë së Shkronjave" në Aleksandri. Më 1884 krijohet në Misir shoqata e shqiptarëve të mërguar "Vëllazëria Shqiptare". Në letërkëmbimin e Dervish Himës me Ibrahim Temon, gjatë vitit 1901, mësojmë për përpjekjet e Ismail Qemalit për të formuar në Egjipt një shoqëri të shqiptarëve : "Vëllazëria Shqiptare".

Kjo ishte atmosfera që gjeti Çajupi kur u vendos në Kajro, në jetën e të cilit do të mplekseshin ngushtë veprimtarinë politike në gjirin e shoqërisë shqiptare të Egjiptit me veprimtarinë letrare dhe publicistike. Afirmimi i bujshëm i tij u bë me botimin e artikullit. "Duke kërkuar një alfabet", në të cilin Çajupi mbron tezën e përdorimit të alfabetit latin në shkrimin shqip. Ishte një moment i rëndësishëm që do ta lidhte Çajupin menjëherë me personalitetet e kohës në rrethet patriotike, brenda dhe jashtë Egjiptit. Gjithashtu frut i atmosferës patriotike të këtij mjedisi ishte edhe botimi i "Baba Tomorrit" 1902, i cili afirmonte shkrirjen e ndjesisë poetike me angazhimin e lartë për çështjen kombëtare.

Po këtë vit (1902), Çajupi është anëtar i shoqatës "Vëllazëria të Egjiptit". Ai ndihmon patriotët e kohës për botimin e revistave dhe librave të tyre. Mban letërkëmbim me disa prej tyre, si Asohenin, me të cilin shkëmbejnë informacione dhe ide për lëvizjet dhe veprimtaritë e shqiptarëve në kolonitë ku bënë pjesë.

Në vogëli Andon Zakoja, i cili më pas pëlqente ta thërrisnin me pseudonimin Çajupi sipas emrit të një mali jo larg vendlindjes së tij, ndoqi shkollat në gjuhën greke në krahinën e lindjes, kurse më 1882 emigroi në Egjipt, ku studioi pesë vjet në liceun e Aleksandrisë. Më 1887 vajti të studiojë për drejtësi në Universitetin e Gjenevës. Përfundoi atje studimet për jurisprudencë më 24 tetor 1892 dhe mbeti në Zvicër për një dy a tre vjet të tjerë, ku edhe ishte martuar me një vajzë të quajtur Evgjeni, me të cilën pati një djalë, Stefanin.

Etapa më e rëndësishme e veprimtarisë letrare e kombëtare të Çajupit është nga 1898 deri më 1912. Më 1902 ai ishte anëtar dhe veprimtar i Vëllazërisë së shqiptarëve të Egjiptit dhe po atë vit botoi vëllimin me poezi për të cilin ka mbetur i mirënjohur, Baba-Tomorri, Kajro 1902¹².

Gjatë 10-vjeçarit të parë të shekullit XX patriotët e kolonisë shqiptare të Egjiptit, bënë disa përpjekje për t'u lidhur me koloni të tjera shqiptare. Rritja e lëvizjes kombëtare në Shqipëri do të gjente

¹¹ Floresha Dado, *A. Z. Çajupi jeta dhe vepra*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 58.

¹² Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001, f. 253.

jehonë të fuqishme edhe në koloninë e Egjiptit, e cila jo vetëm idealisht, por edhe konkretisht jep ndihma në të holla për përgatitjen e luftës së armatosur në Shqipëri.

Viti 1908 është i ngarkuar me një varg ngjarjesh të rëndësishme, që lidhen me fatet e kombit shqiptar. Në gjirin e lëvizjes kombëtare janë kristalizuar dy rryma kryesore: a) rryma që del me programin e kryengritjes së armatosur, b) rryma reformiste, që mbështetet kryesisht në reformat, siç qe mbështetja që iu bë lëvizjes xhonturke, e cila solli vendosjen e kushtetutës së Perandorisë turke¹³. Vitet 1910-1912 thellojnë bashkëpunimin midis shoqërive shqiptare jashtë Atdheut: në Amerikë, Bukuresht, Sofje, Egjipt, Çajupi reagon si pjesëmarrës aktiv, por qëndrimi i tij shkaktoi, në një farë mënyre, armiqësinë e qarqeve të caktuara greke. Është ky moment, kur ai merr një ftesë nga bashkëatdhetarët, të cilët, me sa duket, ose kërkojnë që ai të jetë përfaqësuesi i Gjirokastrës në qeveri, ose i propozojnë ndonjë detyrë tjetër të rëndësishme në Shqipëri. I prekur Çajupi i shkruan mikut të tij Vruhos: “Sa për punën e Gjirokastrës në qeveri, ose i propozojnë ndonjë detyrë tjetër të rëndësishme në Shqipëri.

I përfshirë tashmë në një lëvizje tepër aktive, shkëmben korrespondencë me shumë miq patriot. Më 8 dhjetor 1918, si anëtar i “pleqësisë” së “Vëllazërisë” ai është ndër iniciatorët dhe hartuesit e memorandumit, që u vendos t’u jepej ambasadorëve të Fuqive Aleate dhe SHBA-së në Egjipt. Ishte koha kur Çajupi bashkëpunon ngushtë me patriotët Filip Shiroka, Jani Vreto etj. Por ky vit, i ngarkuar me ngjarje madhore për fatet e Shqipërisë, i sjell goditjen e dytë të madhe, vdekjen e djalit.

Duke iu përgjigjur akuzave që i bëheshin Çajupit, miku i tij patriot, Shiroka shkruante: “Zoti Andon Zako, që nukë ka lënë për pritëse asnjë shërbim për çështjen shqiptare, tuke shkruar e tuke ecur telegrafë në Europë dhe në Amerikë. Zoti Zako nuk resitet, o vëlla, as nga Pleqëria e Vëllazërisë, as nga Vëllazëria, sepse emri i tij nuk resitet nga zembëra e shqiptarëve të Misrit”.

Çajupi vazhdon të jetë i pakursyer në ndihmat që jep për botimin e librave, për pajisjen e klubeve të shoqërisë, ndihma për të dëmtuarit nga tërmeti në krahinën e Tepelenës, për hapjen në Vjenë të një shoqërie botuese.

Gjatë vitit 1929 sëmundja e rëndë do ta shkëpuste nga veprimtaria aktive e shoqërisë shqiptare të Egjiptit. Një vit më pas, më 1930, shqiptarët patriot të Egjiptit, e varrosin poetin dhe patriotin e madh në kuvendin Sen Zhorzh.

Nëse lexuesi shqiptar, e ka futur Çajupin në vetëdijen e tij artistike vetëm si poet të vargjeve plot ndjenjë e zemërim, si një ndër dramaturgët e letërsisë shqipe, si komediografin më të madh të kohës së vet, si përshtatës fabulash, ku është vështirë të ndash kufirin midis përshtatësit dhe krijuesit të vërtetë, si publicistin e fjalës së mprehtë etj. Ky lexues ta kuptojë më mirë këtë personalitet vetëm

¹³ Floresha Dado, *Çajupi dhe kolonia shqiptare e Egjiptit*, në: “Kërkime universitare”, nr. 7, Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej”, revistë shkencore periodike, Tiranë, 2003, f. 13-14.

në gjirin e aktivitetit të një ndër kolonive më aktive të shekullit të XIX dhe fillimit të shekullit XX, atë të Egjiptit.

Nga ana tjetër, kur në historinë tonë do të flitet për koloninë e shqiptarëve të Egjiptit, Çajupi është aty, në qendër, i pranishëm dhe gjithnjë koherent në pikëpamjet dhe përpjekjet për çështje kombëtare¹⁴.

“Dy Fjalë” nga Çajupi për shqiptarët në Kairo, Egjipt, (nëpërmjet librit “Baba Tomorri”)

Këto vjersha që dalën sot në dritë janë shkruarë për të rrëfyer që, Shqipja është gjuhë si edhe tjerat, në mos me mirë. Në mos dimë t’a kuvendojmë a t’a shkruajmë si duetë, është se s’duamë t’a msojmë dhe fajn’ e kanë: priftret e hoxhët, kisha dhe xhamia, dhe qeveri e Turqisë. Po fajne më të math e kanë ata Shqiptarët që besojnë të huajtë dhe shitenë e kërkojnë të shesën dhe Shqipërinë!

Ç’është gjua Shqip? Thonë ca kokëprishurë. Gjua Shqip, o vëlezër Shqipëtarë, është gju’ e Shqipërisë; ajo që na flet mëma në djep, ajo e Skënderbeut dhe e shtrëgjushrevet tonë që kanë nderuarë atdhenë, ajo e Gazetavet bukura që dalën në Bruksel anë Sofje e në Bukuresht, ajo e shoqërisë “Përlindja, dhe Dituria” dhe ajo e shoqërivet Italisë, e të tjera e të tjera...S’është mjaft për të bindur që kemi gjuhë të bukurë?

Po kush shitet me ergjënt

Nukë bidetë me mënt...

Këto vjersha ndaenë me tri pjesë pas qëllimit që kanë: 1. Atdheu, 2. Dashuria, 3. Përralla të rrëme e të vërteta. Në mos janë shkruar mir’ e bukur, janë prej zëmër Shqiptari pa ndo një qëllim tjetër për veç dëshira për Mëmedhenë e për shqipenë, për të cilat cili do mëmedhetar duet të punojë sa t’ipetë, pas fuqisë q’i ka dhënë Zoti: kush pak, kush shumë, po është nevojë të puojmë të gjithë për Shqipërinë. U lutem mëmedhetarëvet të më ndjejnë për fjalët e huaj që dotë gjejnë. Po i mjeri!, kam vjet shumë që jam larguar nga Shqipëria dhe s’munt të them se shqipenë e di mirë. Pastaj më duketë se nuk duetë rë qërojmë shqipenë nga gjithë fjalët e huaj, se gjithë gjutë janë lidhur me njera tjetërnë dhe janë huarë: Ç’i mbetetë gjuhësë Francese po të mos ket fjalët latinçe e elinisçe? Ç’i mbetetë gjuhësë Grekut po të qëronetë nga rrënjët e shqipesë? Nuk është pra turp të shqipërojmë fjalë të huaj kur është nevojë, ashtu si kanë bërë gjithë kombet e aytetëruar, Një gjë duetë të kërkojmë e t’a harrijmë: Të shkruajm të gjithë me një alfabet. Ndaj Shqipëtarëtë që shkruajnë libra e gazeta duet të mblidhen e të mentonen mirë për të përdorur gjithë një sua shkronjë, për përparimin e gjuhësë tonë, e cila dotë sjellë mbrodhësinë e bashkimin e Shqiptarëvet dhe lirin e Shqipërisë...

Ndë Kairo, 1902

¹⁴ Floresha Dado, *Çajupi dhe kolonia shqiptare e Egjiptit*, në: “Kërkime universitare”, nr. 7, Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej”, revistë shkencore periodike, Tiranë, 2003, f. 15.

Mesazhi simbolik, që na sjell autori te kjo hyrje e kësaj vepre poetike, është një përfshirje e përgjithshme e shqiptarëve gjithë andej botës. Sepse historia që e përcjell popullin tonë në shumë çështje e krijon formën figurative të trupit të njeriut, që ndërtohet mes mishit (mërgimtarët) dhe kockave (atdheut). Dhe që nga larg andej nga Egjipti na adreson që t'i lëmë inatet e huaja e të brendshme, por të merremi me shqipen tonë, të shkruajmë të gjithë me një alfabet dhe dashurinë për atdheun etj.

Kreu II: Leximi kritik i veprës së Çajupit

2.1 Tradita folklorike në veprën e Çajupit

Njëqindvjetori i botimit të “Baba Tomorrit”, një prej veprave më të rëndësishme të Rilindjes, u bë shkas për të vështruar në retrospektivë leximin kritik të veprës së Andon Zako Çajupit¹⁵.

Originaliteti i një poezie aq të këndshme e të larmishme, të thjeshtë dhe energjike si ajo e Çajupit, originalitet ky i brendësisë dhe i formës, mund të zbulohet në plotësinë e tij vetëm duke parë lidhjet e kësaj poezie me traditën poetike të kaluar dhe bashkëkohëse¹⁶.

Nëse publikimi i veprës së Çajupit e ka kapërcyer shekullin, po të përfshijmë edhe publicistikën, është fakt që leximi kritik i veprës së tij po e mbyll shekullin. Është e vërtetë që artikulet e para të leximit të veprës kanë qenë të menjëhershme pas botimit të “Baba Tomorrit”, por fillimet e mirëfillta të leximit kritik e estetik të saj lidhen me emrin e Konicës, që, pa munguar të flasë për poezinë patriotike të Çajupit, për poezinë satirike dhe rustike të tij, për gjuhën e poetit që “është e fortë, e hijshme, pa lule të tepërta e të panevojshme”, shpreh konsideratën e tij entuziaste dhe profetike njëherësh “na leu një vjershëtor”¹⁷.

Veçmas nga gjithë të tjerët Çajupi kritikën ndaj fesë e sjell në pikë të fundit, në mohimin e saj total si ideologji dhe si dogmë pse nuk bazohet në fakte historike, shoqërore, politike e sociale:

*Prifti, Hoxha, kisha dhe xhamia
na gënjejnë...U prish Shqipëria*¹⁸.

Leximi kritik i veprës së Çajupit ka dhënë ndihmesë në personalitetet më të njohura e me të afirmuarit në rrafshin e leximeve kritike dhe studimore, si: F. Konica, G. Petrota, V. Kokona, M. Kuteli, Dh. S. Shuteriqi, S. Spase, E. Çabej, E. Koliqi, N. Bulka, M. Gurakuqi, A. Varfi, R. Qosja, A. Uci, A. Aliu, K. Kodra, A. Xhiku.

Sprovën e parë për një receptim kritik të figurës dhe të veprës së Çajupit në një punim monografik, pas publikimit të disa artikujve, e bëri Gj. Zhej (1966), që u pasua nga dy monografi me vlera të mirëfillta dhe origjinale shkencore që në mënyrë të pavarur arritën në një vështrim integral të jetës dhe veprës së poetit. Me monografitë e tyre studiuesit Floresha Dado (1983) dhe Mahmud Hysa (1982) shënuan rezultate të dukshme, pas botimit të kohëpaskohshëm të disa artikujve.

¹⁵ Shaban Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Naimi, Tiranë, 2010, f. 9.

¹⁶ Floresha Dado, A. Z. *Çajupi jeta dhe vepra*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 58.

¹⁷ Fatbardha Fishta, *Leximi kritik i veprës së Çajupit*, në: “Kërkime universitare”, nr. 7, Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej”, revistë shkencore periodike, Tiranë, 2003, f. 49.

¹⁸ Andon Zako Çajupi, *Vepra*, f. 47.

Në veprën e Çajupit ka shumë botë shqiptare. Duke ardhur prej një Shqipërie hyjnore, siç ishte tek Naimi dhe De Rada, në një Shqipëri me halle, me cene, me trille, me kufizime dhe psikoza, Çajupi e çliroi letërsinë shqipe prej kompleksit të lashtësisë dhe të “motit të madh”, duke provuar se mund të shkruhet poezi e mund të bëhet art edhe prej një realiteti problematik¹⁹.

Të gjithë ata që janë marrë me veprën dhe personalitetin e Çajupit e kanë klasifikuar si një ndër personalitetet letrarë nga më të shquarit apo nga më të spikaturit e letërsisë shqiptare, si një nga themeluesit e poezisë dhe poemës saterike, si krijues i komedisë, nga autorët që i çeli udhën realizimit të letërsisë shqipe dhe zë vend nderi në panteonin e kulturës shqiptare.

Edhe pse rrethanat jashtëletrare nuk luajnë rol përcaktues në karakterin e veprave letrare, ato janë shqyrtuar, në rastin e Çajupit, për faktin se poeti do të përjetonte dhe reflektonte poetikisht kulmin dhe kapërcyellin e një epoke të jashtëzakonshme në historinë shqiptare, siç qe Rilindja Kombëtare, që pati emblemë dalluese lirinë e kombit dhe të njeriut²⁰.

Në fillim të shekullit XX Çajupi do të hynte në letërsinë shqiptare me zërin e tij të veçantë, lart kushtrues, si shkruan Koliqi për poezinë e tij patriotike; fshikullues në satirë, siç shkruan Konica për poezitë e tij satirike; por edhe plot “njomësi ndjenjash, ëmbëlsi shprehjesh dhe naivitet të këndshëm” në poezinë erotike, siç shkruan Vedat kokona në fillim të viteve ‘40’²¹.

Një moment tepër interesant në vlerësimin e veprës së një shkrimtari përbëjnë burimet e formimit letrar. Ata janë kërkuar dhe gjetur, pothuajse nga të gjithë studuesit që janë marrë me këtë problem, kryesisht në rrafshin e brendshëm, lidhur ngushtë me pasurinë shpirtërore e kulturore të bashkëkombësve të tij, me thesarin e urtësisë dhe vlerave letrare popullore, sidomos të krahinës nga vinte poeti, që shquhet për koloritin e veçantë të gjithë trashëgimisë shpirtërore²².

Ndërsa Ernest Koliqi shkruan: “Çajupi nga studimet në gjuhën frënge nxori atë stil të tij të lëvizun e të përpiktë, nëpër të cilin tejshihen mendimet dhe ndjesitë si në valët e një uji të kulluet. Porse kësaj kthjelltësie kristalore u japin një drithje të lyvertë parafytyrimet që rrjedhin nga njohja që ka autori me letërsinë lindore”²³.

Intriguese, interesante dhe të suksesshme në leximin kritik të veprës së Çajupit kanë qenë lidhjet e saj me vlerat popullore në përgjithësi dhe folklorin një veçanti, sidomos të krahinës së Zagories. Që në vitet ‘30 Eqrem Çabej theksonte “Shpirti i tij u mbrujt me këngët popullore... Nga kjo shpjegohet

¹⁹ Shaban Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Naimi, Tiranë, 2010, f. 9.

²⁰ Fatbardha Fishta, *Leximi kritik i veprës së Çajupit*, në: “Kërkime universitare”, nr. 7, Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej”, revistë shkencore periodike, Tiranë, 2003, f. 50.

²¹ Vedat Kokona, *Shkrimtarë shqiptarë*, vëll II, Tiranë, 1940, f. 112.

²² Fatbardha Fishta, *Leximi kritik i veprës së Çajupit*, në: “Kërkime universitare”, nr. 7, Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej”, revistë shkencore periodike, Tiranë, 2003, f. 51.

²³ Ernest Koliqi, *Çajupi e Mjeda në qindvjetorin e lindjes*, nw: revistwn “Shejzat”, nr. 5-8, Romë, 1966, f. 53.

në vjershat e tij ritmi dhe metri i poezisë popullore të Zagories, shprehja e lehtë dhe e rrjedhshme, krejt popullore²⁴.

Nga këto dy vargje mund të ndërtohet një konkluzion i tërë me shumë interes për ndërtimin e vetëdijes kombëtare mbi ate konfesionale, apo për sundimin e të parës mbi të dytën. Kështu mund t'i ndërtojmë dy premisat e para: Prifti dhe Hoxha u predikojnë shqiptarëve dogmat fetare në kishë dhe xhami: premisa e parë.

Predikimet e priftit dhe të hoxhës në kishë e xhami janë gënjeshtër përse i përket armiqtësisë konfesionale: premisa e dytë.

Letërsia shqiptare deri te Çajupi nuk ka pasur ashtu figurë të shquar dhe të guximshme që të konfrontohet me dogmat fetare të cilit do regjion. Nëse Naimi përvetësoi konceptin panteistik, apo nëse rilindasit kërkuan që uniteti konfesional t'i nënshtrohet unitetit ndërkombëtar, nuk u zhvillua diskutim mediativ apo poetik mbi dogmat fetare. Këtë temë i pari e trajtoi Çajupi duke i vënë para dilemës disa nga dogmat më të dallueshme. Në këtë kontekst dallojmë: kritikë Dhjatës, kritikë treshit të shenjtë, kritikë krijimit të botës dhe kritikë jetës së përtejvarrit. Çajupi shkroi veprën *Baba Musa lakuriq* të cilën në variantin e parë e quajti *Dhjatë e vjetër e çfaqurë*. Të dy variantet e titullit kanë një atribut që flet për vetë karakterin e veprës dhe për qëndrimin e autorit ndaj këtij libri tabu. Pra, atributet "lakuriq" apo "i çfaqur", edhe pse me kuptimësi të ndryshme, kanë emërues të përbashkët që të çveshet mistika nga fytyrat biblike apo tu tregohet realiteti, prapaskenat, absurditet e Dhjatës, ta shfaqë ate që kërkon logjika njerëzore.

Stili i Çajupit edhe atëherë kur është humoristik, satirik, apo sarkastik është fare i kuptueshëm, i lehtë, i thjeshtë, ashtu si edhe i ngrohtë, i qëndrueshëm, konstant, pikërisht ashtu siç e thoshte edhe Paskali, se veprat më të mira janë ato për të cilat secili lexues mendon se mund t'i shkruajë. Një përshtypje të tillë fiton lexuesi kur lexon veprën e Çajupit pse ndahet prej saj i kënaqur, i lumtur pse armatoset me njohuri, ironia e sarkazma e plotësojnë tërësinë e fenomenit realist të veprës së Çajupit.

2.2 Veçori të ligjërit poetik në veprën e Çajupit

Duke parë në një plan më të gjerë historikio-letrar, duhet thënë se poezia e Çajupit solli tipare të reja në letërsinë tonë. Ai jetoi në periudhën kur kishin filluar të rriteshin lëvizjet shoqërore, prandaj motivet demokratike zunë vend në veprën e tij në mënyrë më të dukshme se të paraardhësit²⁵.

²⁴ Eqrem Çabej, *Elemente të gjuhësisë dhe të literaturës shqipe*, Tiranë, 1936, f. 50.

²⁵ Floresha Dado, *A. Z. Çajupi jeta dhe vepra*, Rilindja, Prishtinë, 1986, 101.

Është thënë me të drejtë se Çajupi e fillon veprimtarinë poetike nën ndikimin e poetikës së Naim Frashërit. Mirëpo, ai shpejt çlirohet prej saj duke kaluar nga poetika romantike-iluministe në ate realiste. Këtë prosede e aplikon që në veprën e parë *Baba Tomorri*, por më shume e thellon në veprën e dytë *Baba Musa lakuriq*.

Prandaj prosedeu realist nuk është dukuri e rastit, por veçori e poetikës së tij, e dellit poetik, e ndikimeve nga letërsia popullore dhe nga letërsitë e huaja.

Madje edhe prosedetë romantike Çajupi i kundron nga aspekti realist dhe u jep ngjyrën e kësaj metode. Prandaj edhe pse temë dominante e krijimeve të tij është ndjenja patriotike, ai i largohet patosit, ekzaltimeve, ofshamës psherëtimave dhe sidomos reprodukimit të së kaluarës historike duke e vështruar gjendjen politike ashtu siç është: të privuar, të poshtëruar, të shtypur, të përçarë dhe për ta tejkaluar këtë gjendje si askush tjetër jep kushtrimin për luftë të armatosur, nxit sedrën, demistifikon klasat feudale e borgjeze, fton masat popullore në luftë vendimtare.

Megjithatë, duhet theksuar se tema patriotike është dominante e prosedeut të tij krijues, asaj i nënshtrohen të gjitha temat tjera qofshin ato romantike apo realiste.

Nëse Andon Zako Çajupi bëri një hap përpara në prosedetë realiste dhe realiste kritike për të cilët dallohet nga të gjithë paraardhësit vetëm me prosede romantike-iluministe, ai me zhanrin poetik mbeti vetëm romantik.

Çajupi është kryesisht poet, poet i ndjenjës lirike edhe kur akcepton forma të poezisë epike apo dramaturgjike. Megjithatë ai diti t'ia përshtasë prosedeut realist vargun adekuat duke krijuar një varg të qartë, të ëmbël, të thjeshtë, të kuptueshëm dhe të natyrshëm. Prandaj ai u bë shumë i afërt e i dashur me masat popullore pse diti edhe çka asaj i dhemb, edhe si t'ia komunikojë ate që e ndjente dhe mendonte. Vjersha lirike është dominante e zhanrit poetik, por jo ajo kontemplative, kozmike, meditative e romantizmit, por jo ajo e lirikës shoqërore, intime, sociale dhe patriotike.

Në vend të epit romantik që e krijuan De Rada, Dara, Bilota, Naimi, ai krijoi parodinë me të cilën hapi mundësitë e mjaftueshme që të shpreh bindjet dhe pikëpamjet e veta shoqërore, sociale, etike, pedagogjike, patriotike, erotike, antifeudale, antiklerikale pa kursyer edhe personat e afërt, qofshin ata prindë, shokë, letrare, patriotë që i shihte se kanë devijuar rrugën e interesit kombëtar. Prosedeut realistë e realisto kritik i dha mundësi të mjaftueshme shprehese edhe prirja e veçantë e autorit për satirë, ironi, e sarkazëm, në çmënyrë ai dhe iu qasë shoqërisë nga këndi polivalent. Madje edhe kur flet për temën patriotike dhe ate erotike, ai ka dëshirë të satirizojë, të ironizojë me vetvetën e me të tjerët, veçmas kur flet për shtresat e privileguara. Një rol shumë dimensional luan edhe epiteti në veprën e Çajupit që është nga më të ndryshmit e më të fuqishmit.

Andon Zaku është ndër të vetmit letrarë të letërsisë së Rilindjes Kombëtare që para se të botojë *Baba Tomorrit* nuk ka qenë i njohur për opinionin lexues me diçka poetike, përveç se me artikullin *Duke kërkuar alfabet*. Tregimet e tij të vetme, *Mysafirët e Çajupit* dhe *Historia e një familje* që mendohet se janë të periudhës para *Baba Tomorrit*, mbetën dorëshkrime dhe u botuan shumë vonë pas vdekjes së autorit,²⁶ megjithëse nuk është plotësisht e sigurtë se janë të kësaj periudhe. Natyra krijuese kërkon që krijimet e para t'i lexohen një rrethi të ngushtë të miqve, ashtu siç pohon edhe Rexhep Qosja²⁷.

Andon Zaku qysh gjatë shkollimit të tij në Nivani ka fituar shprehinë që shpesh herë më shokët e tij të bisedojë përmes vargjeve, të përpilojë poezi të shkurtëra satirike për shokët, për mësuesit, për bashkëfshatarët²⁸.

Madje vargjet e tij të para që mbahen mend nga bashkëkohasit janë:

Shini, shini te Kagjini

*Sesi luhet skadili*²⁹.

Flasin pikërisht për diellin e tij satirik. Gjithë historianët e letërsisë janë të mendimit për sa i përket çështjes së prozës së Andonit se ajo duhet të jetë krijuar para tetorit të vitit 1898, pra, para se të botohet përfundimisht artikulli *Duke kërkuar një alfabet* në kohën kur Andoni shkruante edhe frëngjisht. Përkthyesi Petro Mandi pyet: "S' dihet përse autori e kishte shkruajtur në gjuhë të huaj". Kjo mendoj se vë nga shkak se Andoni në këtë kohë ende nuk kishte filluar të shkruajë në gjuhën shqipe, nga motive objektive.

Ai ka njohur gjerësisht letërsinë franceze dhe pjesërisht atë botërore, mbase ka pasur rastin të shohë e të lexojë për përgjegjësinë e madhe të një krijuesi mediativ ndaj veprës letrare dhe me të drejtë nuk ka marrë guximin të shkruajë në shqipet duke mos e ndjerë vetën të sigurtë. Prandaj ajo që thotë se "Vendosa të merrem me mësimin e saj (të gjuhës shqipe M. H.) seriozisht dhe pa reshtje"³⁰ do të thotë se ka filluar ta mësojë shkencën e gjuhës dhe artin poetik.

Vepra *Baba Musa Lakuriq* lindi pikërisht në kohën kur u zhvilluan polemikat rreth *Baba Tomorrit*, qofshin ato në favor apo disfavor të tij. Kështu, qëndrimi inkuziues i Vasil Zografit në gazetën *Përlindja shqiptare* që në qershor të vitit 1903, qëndrimi nihilist i shtypit të Egjiptit po ndaj kësaj vepre, epigram i Milo Duçit, qenë disa nga rrethanat provokuese që e shtynë Çajupin t'i përvishet një

²⁶ Revista, *Nëntori*, 1966, f. 124.

²⁷ Rexhep Qosja, *Shkrimtarë dhe periudha*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1975, f. 55.

²⁸ Telemak Andoni, art. i cituar.

²⁹ Ylli, 1966, nr. 3, f. 10.

³⁰ Letër e Çajupit dërguar Vis. Dodanit, Kairo, 4 oktobër 1898.

vepre kaq serioze, kaq interesante, kaq të befashme sa për parodinë që i bën librit të shenjtë, sa për temat nga aktualiteti ku frishkullon imoralitetin feudal-borgjez, ose shpreh krenarinë për atdheun dhe bashkëatdhetarët e tij. Armiqësia e nisur që më parë me Adhamidhin duket se vazhdon edhe tash pas daljes së *Baba Tomorrit*:

*Adhamut o mendje hirë
Kur pëlqen të rrosh me brirë
Pse s'pëlqen vjershat që shkrova
Se brirët e tu këndova³¹.*

Dhe Çajupi këtë qëndrim armiqësor të Adhamidhit e arsyeton me sedrën e sëmurë të njeriut që ka parë veten në vargjet e veprës. Po nëse këtë e ka prituri disi, ai befasohet së tepërmi nga qëndrimi i Vasil Zografit. Prandaj me të këtu zhvillon gjithashtu një polemikë poetike që është pak e njohur pse ajo e mlllefosi dhe e dëshperoi me të drejtë quke qenë fare e paargumentuar:

*Po Vangjel Zografi vulli
Vulli helmin, vulli vrerë
Më tepër se nga të tjerët
Ç'nukë vulli ky për mua
Tha e tha sa ju tha gjuha*

Dhe prandaj shprehet me breshër fjalësh:

*Cinë frikon mor i marrë?
Duket Labret s'i ke parë,
Nukë të njo cili je,
Po duket se ç'koka ke
Me një kokë dyzet okë
Gomar që nuku ke shokë!³².*

Veprën *Baba Musa lakuriq* e fillon me poezinë *Balta*, por kjo s'do të thotë se veprën duhet ta ketë filluar më 1904 kur këtë e boton, por shumë më herët, pas qershorit 1903, kur botohet artikulli dezignues i Vasil Zografit, në mos si koncept edhe më përpara. Këtë bindje na e formon letra e

³¹ BML f. 26.

³² Aty f. 26.

Çajupit drejtuar Asdrenit të cilit që në shtator të vitit 1903 i thot se “po bëj gati një libër shqip me emrin Dhjat’ e vjetër. Ky libër besoj të botohet për pak kohë”³³.

Edhe revista Albania në rubrikën “Lajme të reja” jep lajmin: “Mësojmë se vjershëtori A. Z. Çajupit autor i *Baba Tomorrit* është duke gatitur një tjetër libër vjershash”,³⁴ lajm të cilin e shpall me siguri në sajë të korrespondencës që ka pasur drejtori i saj, Faik Konica me Çajupin dhe sigurisht fjala është për veprën *Baba Musa lakuriq*. Nuk e dijmë se në ç’fazë ka qenë atëherë, por sigurisht se nuk ka qenë e gatshme për botim pasi aty kah faqja 175 përmend jo vetëm vdekjen e Samiut që është më 1904, po edhe atë të Papa Kristo Negovanit që u masakrua në janar 1905.

Sidoqoftë duhet ta ketë përfunduar kah viti 1905 ose 1906 po për të nuk kemi të dhëna të jashtme. Sidoqoftë vepra shënon kontinuitetin përmbajtësor dhe formësor me veprën e parë, ndoshta më tepër me të parën se sa me ato që pasojnë pasi shumë motive kristalizohen, formësohen, zgjerohen ose nxjerrin krye për herë të parë.

Edhe pse ka bërë më tepër adaptime sesa përkthime duke mos u kufizuar të fusë në shumë momente vargje të tëra origjinale që i flasin kësaj vetëdije dhe aktualitetit politik të kohës. Kjo periudhë vazhdon edhe në vitin 1922, kur e botoi përmbledhjen *Lulet e Hindit*³⁵ me poezi të përkthyera në shqipet nga frëngjishtja.

Është kjo një përmbledhje që u përpilua rastësisht siç tregojnë bashkëkohanikët: “Bleva një libër me poezi indiane frëngjisht- tregon një bashkëkohës. Nga konteksti i një impulse të ri krijues lind pyetja: pse Çajupi nuk i botoi veprat për të gjallë të vet, qoftë atëherë kur i botoi, qoftë më vonë kur e paralajmëroi botimin e tyre? Kësaj pyetje mjaft interesante është munduar t’i përgjigjet pjesërisht vetëm Dhimitër Shuteriqi³⁶, kur bën fjalë për fatin e veprës *Baba Musa lakuriq*. Të shumta janë, sipas Shuteriqit, arsyet pse s’u botua kjo vepër: nuk deshte të trazonte marazet e dikurshme, ndoshta iu zbenë grindjet politike, pati çaste skepticizmi, nuk desh të çfaqë botërisht ateizmin e tij, ndoshta nuk desh të prishej me miqtë e dashur si Vruhon, Shirokën e Milo Duçin, ndoshta pse nuk gjente aq art në veprën e tij dhe e përfundon me mendimin: “Fakt është se intrasigjenti Çajup u step dhe më shumë se u step dha përshtypjen se u tërhoq”.³⁷

Në këto pyetje hipotetike të Shuteriqit ka prej tyre që mund të pranohen pjesërisht vetëm për veprën *Baba Musa lakuriq*, po jo edhe për zgjidhjen komplekse të këtij problemi.

Me poetikën e saj të re, me temat e saja të reja, me notën revolucionare dhe shoqërore, kjo letërsi realiste dhe madje atë të realizmit kritik. Kjo letërsi do të hapë një rrugë të re dhe do të krijojë

³³ Letër Aleks. St. Drenovës, Kairo 1903, 11 shtator.

³⁴ Albania 1903, f. 15.

³⁵ Lule të Hindit, vjersha sanskrite të shqipëruara, Kairo 1922. Prej tash vetëm LH.

³⁶ Dhimitër Shuteriqi, *Nëpër shekujt letrarë*, f. 395.

³⁷ Po aty, f. 398.

traditë që letërsia në mes dy luftërave botërore të jetë më e avancuar, e drejtuar kryesisht në temat dhe problematikën shoqërore, në pasqyrimin e luftës kryesore, në demistifikimin e shoqërisë feudalo-borgjeze të kohës.

Andon Zako Çajupi u paraqit në letërsinë e Rilindjes Kombëtare pikërisht në kohën kur ideologët, letrarët, iluministët, publicistët e letërsisë kombëtare të fundit të shekullit XIX po përfundonin jetën e tyre bashkë me veprimtarinë për të cilët vështirë mund të besonte njeri se do të gjenden të tjerë që do të arrijnë, ta përcjellin, ta mbajnë gjallë ate traditë, ta pasurojnë dhe ta avansojnë me tipare të reja në përfaqje me kohën, me kushtet, me nevojat. Çajupi arriti, në mënyrë kreative të futet në rrjedhat e Lëvizjes Kombëtare duke i dhënë asaj impulse të reja në përfaqje me aktualitetin historik, shoqëror, social e vetëdijësor.

Vepra e tij e parë *Baba Tomorri* tregon sa për pasardhësin e letërsisë romantiko-iluministe të fundit të shekullit XIX, sa për novatorin e letërsisë së re që po agonte me temat shoqërore. Po edhe në pjesën e parë edhe pse qëndroi shumë afër në temat, kultet dhe etikën kombëtare të paraardhësve, ai edhe aty futi elemente të reja, futi tema të reja që diktonte Lëvizjen Kombëtare, futi tonin kushtues për luftë pa alternative e kompromise, prandaj vepra e tij është shprehje e aspiratave të popullit dhe mbetet dëshmi e gjallë e një etape historike të popullit shqiptar. Prandaj mund të themi se edhe ai ndërton kulte për pikat më të shkëlqyera të së kaluarës dhe së tanishmës. Në këtë aspekt të Çajupi dallojmë: kultin pellazgjik dhe kultin e personaliteteve historike. Në kultin e personaliteteve historike dallojmë ato të historisë së vjetër, të asaj mesjetare, të kohës së re dhe të asaj më të re.

2.3 Tradita dhe modernja në veprën e Çajupit

Tradita e përkthimit të veprave letrare nga letërsia botërore e nisur nga Naim Frashëri tani me Çajupin merr një dimension të ri, më të gjerë si nga vëllimi, ashtu edhe nga cilësia. Në këtë kontekst jep kontribut të madh në letërsinë për fëmijë duke përkthyer një numër të madh fabulash të La Fontenit. Si përkthimi i poezive të Tibulit, si ai i poezive sanskrite, si ky i fabulave, është një përkthim i lirë sipas konceptit vetanak: të plotësohet një zbrazëtirë në edukimin e fëmijëve tanë dhe të ndikohet në formimin dhe ngritjen e ndërgjegjes kombëtare dhe përmes letërsisë së përkthyer.

Çështja e ndikimeve edhe për veprën e Çajupit paraqet interes që duhet hedhur dritë të re. Ka kritikë që mendojnë se Andon Zaku e ka tepruar në huazimet nga letërsia popullore që konsiston jo vetëm në motivet, idetë, strukturën poetike, por edhe në vargje të tëra. Besoj se ajo vjen ngase ata nuk e njohin në tërësi veprën e Çajupit dhe poetikën e veprës së tij.

Në vetëdijësimin kombëtar Çajupi vazhdoi traditën në trasenë e këtij koncepti, por është evident fakti se Çajupi foli si askush tjetër gjerë atëher: ashtu qartë, ashtu guximshëm, ashtu prerat, ashtu luftarakisht, ashtu vendosmërisht, qoftë për anët negative të lëvizjes, qoftë për ato pozitive, qoftë

për heronjtë e popullit shqiptar, qoftë për armiqtë, për grekomanët, për turkomanët, për sulltanin, për mbretërit, për feudalët e huaj apo për ata të vendit.

Qëlloi furishëm, me tërë forcën atje ku hetoi qëndrime negative pa marrë parasysh strukturën shoqërore të njerëzve që merrte në shënjestër, por diti të përkdhelë, të demonstrojë bukuri e dashuri të pashoqe ndaj asaj që mendonte se është pozitive, e shëndoshë, e favorshme në Lëvizjen Kombëtare. Këtë mjaft bukur e metaforizon Nonda Bulka kur flet për poezinë e tij patriotike: “Një lule mbin shkrepat e Zagorisë, kjo që kundërmonete erë trëndëline kur takohesh me dashuri, ose barut kur takohesh me armiqtë”³⁸.

Rrugët e vetëdijësimit kombëtar janë plotësisht identike te rilindasit tanë pse ato ndërtohen përmes së kaluarës, së tanishmës dhe së ardhshmes, që projektohen nga dy agensat e mësipërm, por që secili dallohet për dy çështje: nga dimensionimi që i jep secilit agens dhe nga vendi që e kundrojnë këtë agens. Në mungesë të dëshmimeve të kulturës mesjetare të kësaj periudhe, shkrimtarët tanë projektuan objekte gjeomorfologjike si vendstrehime imagjinative të kulturës shpirtërore shqiptare, në mënyrë që të materializohet kjo e kaluar. Kështu rilindasit tanë si Kristoforidhi, Naimi, Samiu e tjerë krijuan iluzionin e kulturës material e shpirtërore, aq edhe për të luftuar superioritetin grek të krijuar rreth Olimpikut.

Një trajtim të dyfishtë i ka dhënë edhe Çajupi duke e konsideruar si simbol të unitetit konfesional kombëtar dhe si dëshmitar më të vjetër (Baba Tomorri) të ngjarjeve historike. Tomorri është “Kishë e Shqipërisë”, por vend ku janë strehuar gjithë perënditë dhe prandaj aty vinin të gjithë për të dëgjuar fjalën e shenjtë.

Po Tomorri është edhe dëshmitar i vetëm i jetës që zhvillonin njerëzit trima, mëmëdhetarë, të bëshëm dhe syapatrembur. Këtij mali i është drejtuar shkrimtari të dëgjojë për të kaluarën, të tanishmën dhe të ardhmen, ashtu siç duhet t’i drejtohen edhe shqiptarët e kohës së tij, pse vetëm kështu tash e tutje, ata nuk do të kenë nevojë të shikojnë as drejt Fanarit, as drejt Romës, e as drejt Stambollit³⁹.

Konceptimin e së tanishmes historike Çajupi e projektonte përmes disa formave: stigmatizimit të anëve negative dhe projektimit të rrugëve për çlirim kombëtar. Sipas të parës vërejtje: përçarjen fetare, oportunizmin, demaskimin e feudalëve, urrejtjen për pushtuesin, Turqinë e Greqinë, për tradhtarët, grekomanët e turkomanët, urrejtja ndaj sulltanëve, ndërsa, sipas së dytës: lëndimin e sedrës kombëtare, kushtrimin për luftë, për bashkim, për çlirim, për pavarësi, optimizmin për fitimin e lirisë, besimin në forcat e veta.

³⁸ Nonda Bulka, *Fryma patriotike te Çajupi*, në: “Zëri i popullit”, Tiranë, 1966, 27 mars, fq. 3.

³⁹ Rexhep Qosja, *Kontinuitete*, f. 100.

Para se të shtrojmë përpjekjet për vetëdijësimin kombëtar, duhet të theksojmë se veçori e shprehjes së shqetësimeve të autorit është fakti se temat janë gjithmonë të gërshetuara njera me tjetrën dhe është e vështirë të gjendet një motiv i pastër, madje ngjet shpesh që të njejtës temë t'i kthehet disa herë ose duke e përsëritur, ose duke zbuluar diçka të re. Temat shpesh janë të motivuara sipas principit të shkak-pasojës, pra të ngjeshura, të lidhura organikisht me njera tjetrën dhe çdo ngjarje shkakton trajtim parcial të problemit. Megjithatë, një shkoqitje tematike na ndihmon të njohim në mënyrë më kontinuitive angazhimet dhe shqetësimet e Çajupit, kontributin jo të pakët në zgjimin e vetëdijës kombëtare, faktin se ai ka qenë shumë afër me ngjarjet më aktuale të Lëvizjes Kombëtare.

KREU III: Vendi i Çajupit në komediografinë shqiptare

3.1 Elementet e dramave të Çajupit

Në fushën dramaturgjike Çajupi, ndonëse nuk është aq i frytshëm, por puna e tij në këtë drejtim u prit mirë. Ai shkroi dy komedi dhe dy drama. Deri më tash janë botuar: “Katërmbëdhjetë vjeç dhëndërr”, “Pas vdekjes” dhe “Burr i dheut”, kurse drama “Detyra” edhe sot e kësaj dite nuk e ka pa dritën e botimit.

Vend në lirikën patriotike të Çajupit zunë dhe poezitë kushtuar heroit kombëtar, Skënderbeut. Interesimi për këtë figurë historikë ishte bërë për letërsinë tonë një dukuri e përgjithshme, jo vetëm tek arbëreshët, që në mënyrë të veçantë futën në krijimet e tyre epokën e lavdishme të shek. XV, por edhe për paraardhësit e Çajupit⁴⁰.

Krijimtaria dramaturgjike në traditën tonë letrare zë padyshim një vend modest. Komedia, nga ana e saj, ndonëse e parapëlqyer dhe vetiu e popullarizuar, është po ashtu larg autoritetit që kanë krijuar lloje letrare të tjera, si tregimi, romani, poezia dhe poema.

Me komeditë e Çajupit ka ngjarë më e mira: ato mbeten themeltare në dramaturgjinë shqiptare dhe unike në jetëgjatësinë e tyre artistike. Së pari, në të dyja komeditë e Çajupit rrespektohet natyrshëm parimi i mitit ironik. Në zanafillë humori dhe ironia janë përfutur edhe shfaqur si parodi e romancës. Tek komedia “14 vjeç dhëndërr” kemi parodinë e disa prirjeve romantike, posaçërisht përshkrimet idilike të jetës fshatarake. Tek “14 vjeç dhëndërr” nuk ka tablo “të bukura” të natyrës, nuk ka begati ngjyrash idealizuese, nuk ka as modele shembullore të bashkëjetesës dhe mbarëvajtjes midis vetë njerëzve në disa njësi, si në familje, në fshat, në kurbet.

Natyra e fshatit, Vangjelit dhe Tanës, sidomos Tanës, nuk i fal kënaqësi të rralla shpirtërore, sikundër do të ndodhte në kuadrin e një krijimtari romantike, përkundrazi: midis tyre dha natyrës është prishur harmonia ekzotike, pasi për të jetuar kërkohet punë fizike, lodhje dhe mundim.

*Të të vijë keq për mua,
punët janë të rënda,
s'punoj dot jshtë dhe brenda.*

(Tana)

⁴⁰ Floresha Dado, A. Z. *Çajupi jeta dhe vepra*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 70.

Te kjo komedi, fshati shqiptar jepet i rrënuar, pa gjallëri. Burrat dhe djemtë i largon mjerimi, ata pak që ngelën kundrojnë varfërinë dhe punët e grave. Paralel me varfërinë materiale shkon edhe varfërimi shpirtëror: shpifje, thashetheme, sherre për vogëlsira pa kuptim; një mori vesesh, në një sfond ku pazotësia për ta përballuar me punë krahu jetesën e përditshme, bashkëjeton me përtacinë dhe me zgjidhjet tradicionale të problemeve, sikurse është martesë e parakohshme e Gjinit.

*Mos pyes se ç'grua është,
Si për ara dhe për vështë.
Pun'e saj s'gjendet në jetë.
Punon vetëm sa dhjetë
..nuk marr nuse për sisë
Po për punët e shtëpisë.
Të dijë të ngasë qetë
Se nukë mund t'i ngas vetë
Ta na bjerë dru nga mali.*

(Tana)

Te komedia “Pas vdekjes” miti ironik na shfaqet si parodi e prirjeve anti-Rilindje (që tashmë kishin filluar të shfaqeshin), në përpjekjet për përhapjen e diturisë dhe të shkrimit shqip. Për heroin kryesor komik flet Zeneli (shërbëtori).

Zeneli: *Zotëria është doktor Adham-Uti, nga Frashëri, nga katundi' i Naim Beut.*

Duke qenë rilindas i përkushtuar, duke luajtur rol aktiv në pasurimin dhe përhapjen e kulturës së mirëfilltë shqiptare, Çajupi nuk mund të mos i përshkruajë realisht adhamutët, shëronjës, shkronjëtarë, mashtrues, tradhëtarë, të cilët e kërkojnë emrin e tyre në çdo ngjarje të bujshme, por djersën dhe mundin ua kushtojnë punëve të dyshimta⁴¹.

Te “Pas vdekjes” kemi përsëri një objekt të menduar drejtë: pseudoatdhetarin shqiptar, dështakun ambicioz me cenet e tij më të spikatur, si arrivizëm, kapardisje, shpirtvogëlsi, arrogancë, imoralitet e kokëboshësi. Praninë dhe rrezikshmërinë e këtij tipi shoqëror, i përhapur ndër ne shqiptarët, Çajupi e rrëfen në kohën e duhur, duke na zbuluar, përmes një veprë të mirëfilltë artistike kryetipin, doktor Adham-Utin.

Në komeditë e Çajupit, njëlloj si në komeditë shekspiriane, veprimi dramaturgjik buron ose nga ekzistenca paraprake e një ligji irracional e të pamëshirshëm, ose nga lidhja serioze e veprimit me një situatë absurde. Te “14 vjeç dhëndërr” tema absurde dhe fuqia vepruese e ligjit irracional jepet qysh

⁴¹ Virion Graci, *Çajupi dhe komediografia shqiptare*, në: “Kërkime universitare”, nr. 7, vep. e cit., f. 95-96.

në titull: 14 vjeç! Çfarë? 14 vjeç dhëndërr-situatë absurde. Mandej kjo situatë t'fillohet me seriozitet. Një fëmijë 14 vjeçar, për habinë e tij, e sheh veten të martuar me një vajzë të ritur. Martesa bëhet me qëllim që prindërit e dhëndërit të lehtësohen sadopak nga lodhjet që ju shkakton puna në ara. Për Tanën dhe për Vangjelin zgjidhje tjetër më rracionale e më njerëzore s'paska. I gjithë fshati merr pjesë në sofrën e bollshme të dasmës: këndojnë, përcjellin dolli, shkëmbejnë shakara, domethënë çdo gjë funksionon si ska më mirë, si e do rregulli e zakoni i përbashkët.

*Nuni Këtë kupë do ta pi
Për shëndety të dhëndërrit të ri
Shëndet, të mirë të ketë
Dhe të gëzojë përjetë!*

Situata absurde mbizotëron deri në fund të veprimit dramaturgjik. Ja, menjëherë pas dasmës, në dhomën e tyre të gjumit, dhëndëri me nusen bisedojnë:

Dhëndri:
*Lozim ndonjë lodër?
Të dua si motër.
Nusja
Ç'motër më ka mua
O lumë e përrrua?
Ti më more grua.*

Situata absurde është primare dhe përcaktuese, duke përfshirë tërësisht veprimin dramaturgjik. Në botimin e parë të veprës së tij të parë letrare "Baba Tomorri" 1902, është përfshirë dhe komedia e tij në vargje në katër pamje "Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr". Në të ka treguar një pjesë të jetës shqiptare në katund, zakonet e prapambetura të martesës së djalit katërbëdhjetë vjeç me një vajzë krejtësisht të pjekur. Qëndrimin e panatyrshëm ndaj dhëndrit të vogël, ndonëse nuk është me vend, e arsyeton nëna:

*Nuk dua nuse për sisë,
por për punët e shtëpisë.*

(Pamje I)

Tana nuk e marton të birin për të siguruar vazhdimin e gjinisë familjare dhe lumturinë e të birit, por për të fituar edhe një krah pune, për t'i siguruar vetes një ndihmë si për punët e shtëpisë ashtu edhe

për ato të fushës. E pse nëna mban një qëndrim të këtillë? Të na kujtohet vjersha e Çajupit “Fshati im”, ku është dhënë një notë shumë negative për burrin dembel:

*Burrat nën hije
lozin, kuvendojnë,
pika që s’u bie,
se nga gratë rrojnë.*

Por gjendja nuk është më e mirë as në shtëpinë e Tanës. Burri i saj Vangjeli, një përtac e dembel i madh, nuk punonte e nuk fitonte asgjë. Mbasi nuk mund të mbajnë shtëpinë me punën e përbashkët të burrit e të gruas, Tana e mjerë gjen një rrugëdalje të vetme e të prapambetur, për të martuar të birin e mitur. Në të vërtetë Vangjeli, nuk ishte për një martesë aq të hershme të të birit, por nuk ishte i aftë sa t’i dilte në krye të gjitha punëve të shtëpisë, kështu që kundërshtonte vetëm me fjalë. Andaj Tana nuk e pati të vështirë të ja mbyllë gojën burrit të saj. Vagjeli me një notë protestë e heq përgjegjësinë nga vetja duke thënë:

*Moj grua, bën si të duash
dhe më qafë t’i kesh vetë
(Pamje I)*

kurse Tana përgjigjet:

Em këtu, em n’atë jetë!

Siç shihet nga kjo që u tha më lart në “Katëmbëdhjetë vjeç dhëndërr” Çajupi na ka pikturuar mjaft mirë jetën reale të katundit. Edhe fytyrat që poeti i tall në komedi, janë tipike. Ai nuk na jep vetëm pamjen e grindjes së grave fqinje, por dhe atë në mulli, ose atë të priftit të dehur. E mbi të gjitha, që është edhe për të qeshë edhe për t’i ardhur keq njeriut është situata kur dhëndërrri e quan gruan: herë motër e herë mëmë⁴².

Në Shqipëri, e cila gjithmonë ka patur një popullsi me shumicën fshatare, pa qendra të mëdha qytetesh, deri vonë dramaturgjia nuk u zhvillua kurrë deri ku u zhvilluan poezia dhe proza, dhe as nuk pati ndonjë forcë të madhe tërheqëse për publikun shqiptar. Prandaj, lidhur me dramaturgjinë shqiptare pak gjë mbetet për të thënë për periudhën para gjysmës së dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe, në të vërtetë, po ashtu pak për teatër profesionist para gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë.

⁴² Robert Elsie, *Zhvillimi i dramaturgjisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001.

Megjithatë, me fillimin e shekullit të njëzetë, në Shqipëri drama lindi të paktën si gjini letrare e panjohur. Të njohur në këtë lëmi para Çajupit ishin: Jeronim De Rada si figurë kryesore e arbëreshëve shkroi në Italisht tragjedinë 75 faqëshe “Numidët”, Napoli 1846. Një gjysmë shekulli më pas, në moshë të thyer, autori iu kthye dhe e ripunoi, përsëri në përkthimin italisht, duke e kthyer në pesë akte, “Sofonisba”, damë historike, Napoli 1892, pastaj na vjen arbëreshi Françesk Anton Santori me melodramen e tij “Ermira”. Një yll i ndritur, në qiellin e zbehtë të teatrit shqiptar, në agim të shekullit të njëzetë ka qenë dhe aktori Aleksandër Moisiu (1879-1935) etj.

Poeti i Rilindjes së vonë Andon Zako-Çajupi, i cili pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Egjipt, mori emër si dramaturg pas vdekjes me “Burr’ i dheut”, Kajro 1937, tragjedi në vargje e shkruar më 1907. Kjo dramë mjaft e dobët me temën fort të rrahur të Skendërbeut u botua më 1937 pas vdekjes së poetit. Çajupi ka shkruar edhe një komedi origjinale me një akt, “Pas vdekjes”, më 1910, edhe kjo e botuar së pari në Kajro më 1937 nga Sofokli Çapi. Komedia në katër akte në vargje Katërmëdhjetë vjeç dhëndërr mbeti e pabotuar sa që gjallë, kurse një pjesë tjetër në vargje, me titull “Detyra” ka humbur.

Fabulat e Çajupit – Çajupi filloi herët veprimtarinë në shkrimin e fabulave. Nuk mund të vërtetohet me siguri se a shkroi së pari fabula origjinale, ose i përktheu ato të La Fontenit. Por, qysh në botimet e para, në “Baba Tomorri”, përveç katër fabulave të përkthyer, gjejmë edhe këto origjinale: “I krishteri dhe çifuti”, “Gomari katro”, “Dhelpna e një kokë greku”. E përveç përkthimit dhe përpunimit të atyre të La Fontenit, Çajupi ka përshtatur fabula edhe nga shkrimtarët tjerë të panjohur. Vetëm nga La Fonteni ai ka përkthyer, përpunuar dhe adaptuar shumë fabula. Kështu ai botoi afër 111 fabula, si “Përrallat”, në vitin 1921, ku më së shumti i është përmbajtur origjinalit. Mënyra e të përshtaturit të Çajupit, jo vetëm me përdorimin e termeve popullore, por edhe me përshtatshmërinë e të menduarit logjik dhe të botëkuptimeve të popullit të vet, bëjnë që punën e tij ta trajtojnë lirisht si përpunim. Edhe vet zgjedhja e fabulave i shërben atij për një qëllim të caktuar. Prej këndej del se Çajupi u përmbahet disa temave dhe motiveve, ku duket ecurija e shoqërisë përparimtare: kundër eksploatimit dhe skllavizimit, kundër shkeljes së të drejtave dhe të lirive të popujve etj.

Marrë në përgjithësi, Çajupi edhe këtu na tregohet si i tillë. Ndonëse në këtë botim nga “Përrallat” kemi vetëm 85 fabula, këto do të jenë të mjaftueshme për të na dhënë një panoramë të qartë mbi vlerën estetike dhe ideore. Këtë gjini letrare Çajupi e futi në letërsinë shqipe, për arsye se me anë të tyre, mund të thuhet në mënyrë shumë të thjeshtë të cilën e kupton edhe vetë populli. Çajupi dëshiron që popullit të vet, i cili marrë rrugën e gabueshme, t’ia tregojë gabimet themelore pse i beson sulltanit dhe njerëzve të mëdhenj të Turqisë.

Në këtë mënyrë ai shtjellon fabulën (në Kazëzozat që kërkojnë një mbret, ose dhelpira, majmuni dhe kafshët). Për ata që i besojë fuqisë tjetër, po me at karakter mësimi, është fabula: *“Lopa, dhia, delja dhe luani”*. E njerëzit nuk janë të gjithë të barabartë e *“ma i dobëti asht fajtor”* (Ujku dhe qengji). Por me të këqinj të nuk duhet me u shoqëruar (Njeriu dhe nepërka). Aq më pak me kërkuar ndihmë nga pasha dhe të mëdhenjtë (Kopështari), sepse *“njerëzit e mëdhej”* nuk i ngasin të mëdhenjtë, por të vegjëlit (Kafshët dërgojnë peshqesh te Leka i Madh). Njeriut të keq bëni mirë, e prit keq (Fshatari dhe gjarpri). Më të këqinj janë gjyqtarët (Gleri dhe blea). Në fabula po kështu e ngrit zërin kundër klerit përtac (Përdhësi dhe merimanga), ose në *“Dhjat’e Vjetër”*, e sidomos kundër fesë fabulën *“Një njeri dhe konism’i drunjtë”*. Domethënë: nuk duhet me qenë fetar, por i arsimuar dhe i mësuar (Dituria).

Në jetë më së shumti çmohet liria (Ujku dhe qeni, Kali dhe dreri). Siç u tha dhe më lart, Çajupi e çmon gjuhën e popullit, shprehjen, logjikën dhe formën dhe këto i përdor me të madhe. Mendimet e popullit në fjalët e urta i çmon jashtëzakonisht shumë, prandaj i përdorë shpesh si mjete poetike. Kështu, për shembull fillimet e fabulave (Vdekja dhe një njëri i mjerë), mënyra e të treguarit (Gleri dhe blea, I dehuri dhe gruaja e vet) etj. Përdor vargun trokaik popullor (Korbi dhe dhelpira, Ujku dhe qengji). Ndonëse fabulat e Çajupit, në pjesën më të madhe, janë lektyrë e përshtatshme për fëmijë, ato janë edhe për të vjetrit. Më të vjetrit në to kanë për të gjetur një kritikë të shëndoshë kundër ideve të shoqërisë feudale dhe borgjeze të asaj kohe: kundër varfërisë, kundër ndalimit të lirisë, përtacisë, frikës, koprarisë etj. Kritika kundër shoqërisë së atëhershme zënë një vend të dukshëm.

Vlera artistike dhe gjuha e veprave të Çajupit – Çajupi është një nga shkrimtarët e periudhës së re të letërsisë shqipe të Rilindjes. Ndërsa para tij letërsia shqipe ishte gati krejt romantike, me Çajupin fillon realizmi e aq më tepër realizmi kritik. Ndonëse ishte me origjinë feudale dhe që në fillim i edukuar në frymën feudalo-borgjeze, caku i tij mbërrin deri te kritika kundër shoqërisë borgjeze, por pa iluzione për një shoqëri më të mirë se ajo e republikës demokratike shqiptare. Meqenëse borgjezia shqiptare ende nuk ishte formuar sa duhet, Çajupi sillet në mënyrë shumë kritike ndaj saj, si dhe kundër feudalëve turq dhe paraardhësve të tyre, u mëshon dhe botëkuptimeve patriarkale (Tana dhe Vangjeli), të bejlerëve dhe inteligjencës borgjeze shqiptare (Mit’hat dhe Mehdi-beg Frashëri, Dr. Adhamudhi), e cila e ndihmon lëvizjen e xhonturqve, duke punuar dhe dobësuar lëvizjen popullore çlirimtare. Kryesisht në këtë qëndron ana ideore e veprimtarisë së tij letrare. Në pikëpamje të shprehjes, Çajupi me përpjekjet e tij, të një realisti shkoi larg paraardhësve të tij. Noviteti i tij është ajo që filloi poemën satirike në formë parodie, krijoi baladën epiko-heroike (Atdheu dhe dashuria), ose poema të shkurtra (Zolejka, Kurbeti). Shumë tërheqëse janë satirat e tij politike në vargje, fabulat; po ashtu edhe në komedi dhe në dramë. Krijoi disa personazhe me të vërtetë negativë në letërsinë shqipe dhe pikturoi shoqërinë shqiptare të kohës së vet. Sa i përket

gjuhës së Çajupit, ajo është e vendlindjes së tij, e Zagorisë dhe e Labërisë. Letërsinë popullore gojore e ka gjithmonë si model. Nuk mundohet aq shumë ta pastrojë gjuhën nga elementet e huaja, nga pak përdor edhe gjuhën e krahinave të tjera të Shqipërisë⁴³.

3.2 Komedia 14 vjeç dhëndër

Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr! – Komedia është me katër tablo (Poeti e quan **pamje**). Botojmë pjesërisht vetëm të parën: Çajupi e mori temën nga poezia popullore. Ja një këngë popullore ku vihet në lojë një martesë e tillë:

*Çupë Radoneci,
martuar Radostinë,
qysh ta mallkoj nënën
dhe xhaxha Mersinë,
që më dhanë burrë,
burrë çiliminë.
Unë hy në magje,
ay se ç'më thotë:
- Nënë, bëjm' kulaçe!
- Nuk më ke nënë,
mor purrat i paç!
Mua më ke grua,
mos u bëfsh për mua!*

Pjesa e fundit e komedisë paraqet një skenë të ngjashme: dhëndërr e nuse janë vetëm, në odën e tyre, dhëndërri i flet nuses sikur ta ketë motër ose nënë, ajo ja pret:

*Ç'motër më ke mua.
O lum e përdua?
Ti më more grua!*

Komedia shquhet për dialogun shumë të gjallë. Në pamjen e katërt, që është ajo e dasmës, poeti ka përdorur folklorin për të ndërtuar një skenë të vërtetë dasme popullore, me dolli, këngë dhe valle⁴⁴.

⁴³ Andon Zako – Çajupi, *Vepra*, Rilindja, Prishtinë, 1963.

⁴⁴ Dhimitër Shuteriqi, *Antalogji e letërsisë shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1973.

3.3 Baba Musa Lakuriq

Një demaskim të madh të grekëve dhe grekomanëve, të turqve e turkomanëve e bën në veprën *Baba Musa lakuriq*, edhe pse në momente, urrejtja kalon caqet e objektivitetit dhe të të mundshmës e të të lejueshmës. Në rastet kur flet për çifutët, për veprat e tyre të ndyta morale, gjen asociacione fare të ngjashme te grekët, duke i diskredituar si njerëz të poshtër, të pafytyrë, të liq, të pabesë, që për interes shesin babanë apo vrasin vëllanë, që padrejtësisht krekosen me të kaluaren historike, sepse, sipas Çajupit, historia njih vetëm shtatë grekër të mençur: Talesin e Miletit, Pitakus, Bias, Kleobule, Myron, Chilo dhe Solon. Edhe pse këtë e bën që të ndikojë te grekomanët, t'u tregoë atyre rrugën e gabuar vetëdijësore që kanë marrë, duhet thënë se Çajupi e ka tepruar masën e diskreditimit, veçmas kur futet në çështjet historike, apo kur flet për tërë popullin, koncepte me të cilat natyrisht se nuk mund të pajtohemi.

Duke parë plogështinë e Lëvizjes Kombëtare, amullinë që mbretëronte në disa raste e në disa ambiente, shkrimtari krijon iluzione për mënyrën sesi ta shpëtojë vendin e tij nga armiqtë duke kërkuar shpesh shpëtim nga ngjarje, fenomene, epidemi që menjëherë të zhduken armiqtë, megjithëse nuk i mungojnë as ofertat për luftë të armatosur apo vigjilencë politike. Kur bëhet përmbysja e botës 40 ditë e 40 netë sipas Dhjatës, mbyten në ate rast të gjithë çifutët dhe mbetet vetëm Lloti me vajzat e tij. Të njejtën katastrofë kërkon edhe për turqit, grekët e bullgarët, pse edhe ata janë armiq të shqiptarëve, ose kur Sodoma e Gomorra digjet, ai të njejtën kërkon edhe për sodomazit e gomorrasit e sotëm, bashkëkohanikë të Çajupit, sepse tani ka shumë njerëz të tillë dhe nxjerr dilemën se cilin të djegësh më parë: Romën, patriarkët apo turqit e grekët. Megjithatë, sipas Çajupit, këta të fundit kanë më shumë mëkate:

*Shiko ç'bënetë ndë botë!
Shiko, gjaknë, shiko lotë!
Gjaknë që po derth Turqia
Lotë që po derth Shqipëria!⁴⁵.*

Ose kur Zoti e sheh imoralitetin e Abimelekut ndaj Sarës së Abrahamit e dërgon sëmundjes e pestës për të dënuar popullin për gabimet e sundimtarit të tyre. Këtë sëmundje i lutet Zotit të mos ua dërgojë tash shqiptarëve pse ata kanë një peshë edhe më të rëndë, Turqinë. Megjithatë, të gjitha këto raste tregojnë dëshirën e zjarrtë të shkrimtarit që atdheu i tij të çlirohet sa më shpejt nga këta dy armiq më të mëdhenj të ekzistencës dhe të konsolidimit të tij kombëtar.

⁴⁵ BML f. 63.

Për të krijuar një vetëdije të shëndoshë kombëtare nga një anë dhe antiturke dhe antigreke nga ana tjetër, Çajupi i ven në rrezik konceptet ateiste duke pranuar në një mënyrë konceptin e metapsikozës dhe të botës së ideve ku strehohen shpirtat e secilit pas vdekjes fizike të njeriut. Në këtë botë është ngjitur Naimi dhe Papa Kristua të cilët sodisin vendin e tij dhe për këtë i ankohen Perëndisë: Naimi i ankohet se vendi i tij rënkon nën Turqinë, ndërsa Papa Kristua rrëfëhet për mënyrën barbare të zhdukjes së tij dhe të shtatë patriotëve tjerë. Dhe fuqia mbinatyrore pasi dëgjon dhe vërteton akuzat e Naimit dhe Papa Kristos, lëshon gjithashtu anatemën më të rëndë:

*Dhe nëpërkat e Moresë
Q'i vranë me të pa besë
Mos pafshi ditë të mbarë!⁴⁶.*

Ky është argument më i shëndoshë për të bindur ndërgjegjen e mykur të shqiptarëve fanatikë se Perëndia thotë të kundërtën e asaj që thonë armiqtë. Edhe pse veprën *Baba Musa lakuriq* e shkroi në vitet e një mobilizimi më të madh, edhe pse ngjarjet ndërkombëtare të kohës shkonin në favor të çlirimit sa më të shpejtë, atë shpesh e kapte frika nga plogështia e amullia e Lëvizjes Kombëtare dhe prandaj në momente e sheh të arsyeshme që t'ua tërheq vërejtjen bashkatdhetarëve se mund të vijë ditë dhe më të zeza dhe prandaj duhet patur kujdes e duhet angazhim konkret:

*Hapi syt'o komb i mjerë
Se armiqtë që ke pranë
Për të zotuar të kanë
Dhe tek fryn' er' e Lirisë
Do të fryej er' e zisë!⁴⁷.*

Po Çajupi ka çmuar objektivisht situatën politike kaotike në perandorinë turke, e cila ka një strukturë administrative nga më të korruptuarat, nga më primitive, nga më obskurantistet:

*Shikonë Turqinë e zezë
Ndë ç'shcallë gjendet e mjera!
Turqinë sot ç'njers e hanë?
Dhe kush e ka qeverisur?*

⁴⁶ Po aty, f. 150.

⁴⁷ Po aty, f. 152.

*Ca hamallë, ca rrufjanë,
Edhe ca këpucë-grisur⁴⁸.*

Prandaj shqiptarët nuk duhet të presin ndonjë ndryshim apo përmirësim të situatës nga Turqia se ajo është njëlloj sikur të kërkosh sy nga i verbëri. Autori është i ndërgjegjshëm se liria mund të vijë vetëm nga forcat e vetë popullit shqiptar, nga angazhimi, nga mobilizmi, nga gatëshmëria e secilit për të sakrifikuar individualen për shoqëroren. Prandaj përsëri është e motivuar lufta kundër Turqisë me të cilat vargje përfundon veprën e rëndësishme *Baba Musa lakuriq*:

*Zot, të mos ishte Turqia
Dot' ish lule Shqipëria⁴⁹.*

Vepra me karakter specifik *Baba Musa lakuriq* vazhdon të jetë pasqyrë e gjallë për vendlindjen, këtu madje tregon më tepër ngrohtësi, afërsi, lidhshmëri mes njeriut dhe natyrës duke i dhënë shembull secilit se si duhet ta përfytyrojë vendlindjen në çdo moment dhe me çfarë drite:

*Si Çajupi s'ka në botë
Ndë Çajup të rri një ditë
Të pi një ujë të ftohtë
Të përtëriten mëlçitë.
Përtëritet njeriu
N'ato lule, n'atë bar
Dit' e natë fryn veriu
Dhe zemra bëhet behar⁵⁰.*

Thirrja për luftë çlirimtare që po me zjarrin e *Baba Tomorrit* është prezent edhe me përmbledhjen *Baba Musa lakuriq*, në momente duke u përsëritur konceptet, por edhe duke i plotësuar me premise të reja. Kur konstaton me kënaqësi se Josifi e shpëton Egjiptin nga kriza e bukës që e kapi aso kohe botën, shkrimtari bën lidhje asociative me katastrofën që e ka mbuluar atdheun e tij dhe askush nuk del ta shpëtojë dhe shtron pyetjen:

⁴⁸ Po aty, f. 110

⁴⁹ Po aty, f. 213.

⁵⁰ Po aty, f. 51-52.

*O Shqiptarë të mjerë
neve kush do të na nxjerrë
nga zgjedha që kanë vënë Turqit...⁵¹.*

Shpëtimin e kërkon nga njerëzit e vet, nga bashkëatdhetarët e ndërgjegjshëm dhe nga ata që kishin rënë në strofullën e armikut, si Ferit pashë Vlora dhe Rexhep pashë Mati.

Vepra parodike *Baba Musa lakuriq* është thesar i ndjenjave dhe mendimeve të Çajupit, prandaj gjejmë edhe temën e nostalgjisë për vendlindjen dhe atdheun. Përmes referencave apo pjesëve lirike, shkrimtari zbulon botën shqiptare në kontekstin e një tërësie biblike. Me rastin e largimit të Abrahamit, Sarës e Llotit nga Egjipti për Kanan që të merren atje me blektori, shkrimtari heq një parantezë për të futurë ca pasazhe nga jeta baritore shqiptare për të shprehur mallin për vendet ku zhvillohet ajo jetë. Natyra shqiptare në veprën parodike *Baba Musa lakuriq* fiton segmente të reja që e pasurojnë edhe më tepër dimensionin deskriptiv në veprën e Çajupit: natyrë-nostalgji, natyrë-toponomastikë e gjeografike, natyrë-armë, natyrë-varr, natyrë-fizioterapi, natyrë-psikologji dhe natyrë-psikoterapi.

Në veprën *Baba Musa lakuriq*, përjetimet e heroi lirik, tanimë, për ndryshim, është prezent si ai mashkull, edhe ai femër, kalojnë në planin e lirikës objektive, kryesisht të erotikës fshatare, ku bariu dhe baresha bëhen personazhet e kësaj lirike, duke na krijuar në këtë plan poezitë më të bukura të erotikës së idealizuar (Baresha kërkon barinë dhe Bariu kërkon bareshën). Një moment i rëndësishëm i kësaj faze që ka shkaktuar pështjellim në karakterizimin e erotikës së Çajupit në përgjithësi, është edhe ndërtimi i portretit fizik të heroinës lirike nga arsenali i letërsisë popullore ku vajza metaforizohet si thëllëzë gur më gur, si lulja vergje-vergje, si boziloku fletë gjerë, si shelgje bejke e çobanit, si mollë e kuqe bukuroshe, si manushaqe që mban erë dhe me tiparet e estetikës popullore si zullufet fije fije, faqet mollë kuqe, goja si burbuqe, mesi unazë dore, sy të zeza ndë ballë, që krijojnë një atmosferë të ngrohtë plot ngjyra farfuritëse, plot optimizëm e shpresë. Asgjë në këtë portret nuk mund të shihet e tepërt, e deformuar, joproporcionale, pasi çdo detaj fiziologjik që përbën të veçantën e këtij portreti është në pajtim me formën, madhësinë, ngjyrën e vëllimin. Kështu vërehet harmonia e jashtëzakonshme në mes detajit fiziologjik e objektit të metaforizuar apo të krahasuar.

Teofania te Vepra - *Baba Musa lakuriq* na jep mundësi që përmes teofanisë të njohim më për së afërmi karakterin dhe moralin e Zotit. Gjithësesi me rëndësi është qëndrimi i autorit ndaj kësaj teofanie, sepse në raste ndryshon nga teksti bazë. Kemi disa raste ku shprehet si qënie e gjallë dhe si qënie halutinative. Edhe karakteri apo morali është i njëtrajtshëm, me qëndrime konsekuente: ka

⁵¹ Po aty, f. 196.

raste kur tregohet despotik, hakmarrës, tradicional, po ka raste kur tregohet racional, humanist, moralist dhe mospajtues me fuqinë e mbinatyrore, ndërsa sipas së dytës, qëndrimin identik apo qëndrimin e vet përmes atij të Perëndisë.

Vepra parodike Baba Musa lakuriq qëndron mbi bazën e attributeve kontradiktore që shpërthen gati në të gjitha rastet kur përdoret nocioni Zot. Kështu në vargjet:

*Para Zotit Vërtetë
Gjithë lindemi fajtorë⁵².*

Kontribut të veçantë ka dhënë në veprën *Baba Musa lakuriq*, ku fytyrave biblike u ka ngjashur elemente jashtë biblike të cilat prekin në sferën bashkëshortore. Çiftit të ri, pavarësisht nga rrethanat nga ai krijohet, për të qenë bashkëshortësia e ngulmët u duhet fëmija. Shterpësia e gruas është një nga problemet e pa kalueshme për një bashkshortësi të lumtur dhe këtë mungesë e përjeton më shumë gruaja se burri. Çajupi kësaj pike i kushton kujdes dhe arrin të depërtojë në psikologjinë e të rinjëve. Sara e Abrahamit nuk kishte fëmijë, ashtu si edhe Rebeka e Isakut dhe kjo është brengë e thellë për të dyja gratë:

*Ç'ka Rebeka që rrënkon?
Ç'ka që mban kokën ndë duar
Herë, herë duke qarë?
Njëzet e ca vjet martuar
Barku nuk i vete mbarë...⁵³.*

Problem i titullit tregon se Çajupi i ka kushtuar kujdes zgjidhjes së titullit të veprës i ndërgjegjshëm se ajo shpreh esencën e tërë asaj që tregon të tregojë gjatë shtrirjes së saj horizontale. Vepra ka dy tituj: *Dhjata e vjetër çfaqurë* dhe *Baba Musa lakuriq*. Titulli i parë ka qenë *Dhjat' e Vjetër e çfaqurë*, gjë të cilën e tregon variant i parë i dorëshkrimit, faqe 1, e cila është prishur me tri vija horizontale jo të drejta dhe sipas saj është shkruar po me dorë *Baba Musa lakuriq*. Gjatë veprës ka shumë raste kur shkrintari përmend thëniet e veprës që parodizon, pra të Dhjatës ose të Dhjatës së vjetër. Dhe të gjitha ato raste në variantin e parë i ka prishur dhe sipas tyre, anash ose mbi ta ka shkruar Baba Musa ose Musa. Edhe përshkruesi i variantit të dytë, që duhet të jetë një dorë tjetër, në të shumtën e rasteve e ka pranuar intervenimin, por ka raste kur e vazhdon me të vjetrën, me formën *Dhjata*

⁵² BT, f. 111.

⁵³ BML, f. 134.

ose *Dhjat' e vjetër*. Këtë formë autori ynë në variantin e parë e vazhdon deri në faqen 251 dhe pas asaj e shënon vetëm formën Baba Musa. Kjo do të thotë se ideja për ta ndërruar titullin i ka lindur para se të përfundojë veprën. Kur ishte kjo kohë nuk mund ta caktojmë pasi në letrën që i dërgon Asdrenit me 1903 e përmend formën e parë, që do të thotë se vepra nuk ka qenë gati dhe se titulli i dytë ka lindur pas kësaj date. *Varianti i parë* i kësaj vepre është shkruar në tri fletore, ndërsa *varianti i dytë* është shkruar vetëm në një fletore të madhe me të njejtat dimensione të fletores së parë të variantit të parë dhe me të njejtat karakteristika duke përfunduar tërë teksti letrar.

Përmbledhja *Baba Musa lakuriq* ka poezi me vlerë ideo-artistike ku shprehen ndjenjat nga më të ndryshmet, veçmas malli i pashuar për vendlindjen, që e trazon aq më tepër pse ajo është e robëruar.

PËRFUNDIME:

Andon Zako Çajupi nga ajo që ka thënë kritika historike letrare e gjertanishme dhe nga ajo që del nga shqyrtimi ynë, me të drejtë konsiderohet si prijëtar i një procedimi të ri në letërsinë tonë: i realizmit dhe i realizmit kritik. Dhe këtë nuk e arrin vetëm përmes poezisë, siç mendohej gjer vonë, por edhe përmes dramaturgjisë siç është konstatuar në kohë të fundit dhe nga qëndrimi ynë.

Kritika drejtuar marrëdhënieve shoqërore ka qenë për letrarët prore e padëshiruar pse ajo patjetër e qëllon keqas ndonjërin dhe pason reaksioni që shpesh mund të marrë dimensione shumë të gjëra dhe vendimtare për shkrimtarin dhe veprën e tij. E shkrimtari gjithmonë shikon përpara, drejt një përsosmërie dhe harmonie më të madhe, të cilën do ta arrijë shpeshë duke mohuar apo duke demaskuar të tanishmën e shëmtuar, të kalbur e iluzore.

Jeta dhe vepra e Çajupit në këtë kontekst ka pësuar shumë, më shumë se e çdo shkrimtari tjetër, nga ata që kanë gjetur veten në vargjet apo nëntekstin e vargjeve të tij. Edhe pse ajo mund të konsiderohet si një nga veprat më të afërta si nga temat, si nga mënyra, ajo ka pasur fatin e keq pse ka qenë e shkoqur nga mundësia që të ushqehet me të vetëdija shoqërore e lexuesit të kohës që ka pasur nevojë për brendinë e saj dhe për mënyrën e transponimit të saj. Zakonisht veprat e tilla e bëjnë jetën e tyre më të gjatë dhe shklëqejnë me tërë potencialet në një periudhë të pasbashkëkohësisë, në periudhën kur me të vërtetë realizohen idealet e shkrimtarit, kur ëndërra e tij bëhet zhgënjendërr.

Dhe nëse e kundrojmë veprën e tij nga ky aspekt, mund të themi se Çajupi edhe pse nuk e përcaktoi të ardhmen, nga ideja objektive e veprës së tij del vizionar i realtë. Dhe si për ironi, të paktën me sa dimë gjer më sot, ata që e gjetën veten e tyre në vepër nuk reagues publikisht, por vepruan në mënyrë të nëndheshme duke nxitur të tjerët për kompromentimin e veprës e të shkrimtarit. Çajupi ishte nga ata që nuk u mbete borgj të tjerëve, pra as “shtiekëqinjeve”, sharlatanëve, asimprovizatorëve, as atyre që kamufloheshin e i ngulnin “thikën pas shpinë” popullit dhe lëvizjes kombëtare. Ai përkundrazi e vazhdoi më me zjarr diskreditimin letrar edhe me këta edhe me të rinjt, filistenjt e tyre, gjersa ua zbuloi botërisht fytyrën e vërtetë para opinionit.

Studimet e gjertanishme historiko-letrare dhe letrare të veprës së tij, janë bazuar kryesisht në veprat e shkrimtarit që janë botuar, apo në fragmentet e atyre të pabotuara dhe jo edhe ato që kanë mbetur në dorëshkrimin e tij, pasi që shkrimtari vazhdon në këtë aspekt ta ketë fatin e keq që vepra të jetë edhe sot e kësaj dite e panjohur për qarqet e gjera lexuese.

Vepra *Baba Musa lakuriq* është një burim i pashtershëm për studime të qëndrueshme në tema të ndryshme. Fusha e ndikimeve është poashtu një temë që pret studime komparative në relacionet Çajupi-letërsia popullore, Çajupi-letërsia e traditës dhe Çajupi-letërsia e huaj, konceptet antifetare

po të studiohen në mikroplan mund të na nxjerrin mendime të reja dhe të vlefshme për historianët e mendimit filozofik shqiptar.

Veprën e Çajupit përsa i përket procedimit letrar duhet vështruar nga dy aspekte: në kontinuitet me letërsinë e traditës dhe si inovacion, rrespektivisht si kthesë kualitative në letërsinë e përgjithshme. Sipas të parës është trajtuar motivacioni romantik që hetohet në veprën e tij në tërësi dhe jo vetëm në *Baba Tomorri* e pjesërisht në *Baba Musa lakuriq* siç ka qenë praktika e gjertanishme.

Në këtë kontekst është kërkuar ajo që është e përbashkët dhe ajo që e dallon këtë shkrimtar nga gjithë të tjerët para tij, pasi Çajupi ka krijuar individualitetin e tij krijues menjëherë pas shkrimeve më të para.

Me tri veprat e tij dramatike, Çajupi dha një kontribut të mirë për fillimet e dramaturgjisë shqipe, duke rrokur qoftë temat aktuale, qoftë temën e Skënderbeut, aq të dashur për rilindësit. Ai na dha veçanërisht disa personazhe negative të qëlluara fort mirë, si Tana e Dr. Adhamudhi, pa harruar personazhin simpatik, shërbëtorin Zenel, që u vjen hakut dallkaukëve e mëndjelehtëve. Edhe përpjekja e tij për krijimin e personazheve pozitive të "Burr' i dheut", nuk është për të nënçmuar. Përpjekja e Çajupit për fillimin në shqipet jo vetëm të komedisë së shkurtër, ku ai pati sukses të plotë, po dhe të tragjedisë klasike, është një meritë e veçantë e krijimtarisë së tij.

Çajupi dhe vepra e tij janë dy koncepte që organikisht janë të lidhura njera me tjetrën dhe në mes tyre nuk mund të dallosh asnjë plasaritje. Ata nga ana tjetër kanë aq material sa që e provokojnë secilin studiues që t'i qaset me plot dashuri dhe rrespekt qëmtimit për të ndriçuar jetën dhe veprën e një letrari siç është Çajupi, se letërsia e Rilindjes Kombëtare do të ishte shumë më e varfër në mos edhe e pakuptimtë nëse nuk do të ekzistonte vepra e tij.

BIBLIOGRAFIA:

- Bulka, Nonda, *Fryma patriotike te Çajupi*, në: "Zëri i popullit", Tiranë, 1966, 27 mars.
- Bulo, Jorgo *Andon Zako Çajupi, koha dhe vepra e tij*, në: "Kërkime universitare" nr. 7, Universiteti i Gjikokastrës "Eqrem Çabej", revistë shkencore periodike, Tiranë, 2003.
- Çabej, Eqrem, *Elemente të gjuhësisë dhe të literaturës shqipe*, Tiranë, 1936.
- Çajupi, Andon Zako, *Vepra*, Rilindja, Prishtinë, 1963.
- Çajupi, Andon Zako, *Vepra*, Rilindja, Prishtinë, 1963.
- Dado, Floresha, A.Z. *Çajupi jeta dhe vepra*, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- Dado, Floresha, *Çajupi dhe kolonia shqiptare e Egjiptit*, në: "Kërkime universitare", nr. 7, Universiteti i Gjirokastrës "Eqrem Çabej", revistë shkencore periodike, Tiranë, 2003.
- Elsie, Robert, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001.
- Elsie, Robert, *Zhvillimi i dramaturgjisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001.
- Fishta, Fatbardha, *Leximi kritik i veprës së Çajupit*, në: "Kërkime universitare", nr. 7, Universiteti i Gjirokastrës "Eqrem Çabej", revistë shkencore periodike, Tiranë, 2003.
- Floresha Dado, A. Z. *Çajupi jeta dhe vepra*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 58.
- Graçi, Virion, *Çajupi dhe komediografia shqiptare*, në: "Kërkime universitare", nr. 7, vep. e cit.
- Historia e letërsisë shqipe, I, II, Rilindja, Prishtinë, 1968.
- Kokona, Vedat, *Shkrimtarë shqiptarë*, vëll II, Tiranë, 1940.
- Koliqi, Ernest, *Çajupi e Mjeda në qindvjetorin e lindjes*, në: revistën "Shejzat", nr. 5-8, Romë, 1966.
- Qosja, Rexhep, *Shkrimtarë dhe periudha*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1975.
- Shuteriqi, Dhimitër, *Antalogji e letërsisë shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1973.
- Sinani, Shaban, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Naimi, Tiranë, 2010.